

**Enver Hoxhaj**  
Kosova do ta konkretizojë bashkëpunimin

Fq.3



**BORXHE TË REJA**  
Vetëm për 1 muaj, 100 milionë euro

Fq.4



Çka i shkruante Fan Noli Hiliterit?

**Kulturë**

Fq.18



# Koha

www.koha.mk



“Vulokset” ndarja

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3274 · e mërkurë 24 janar, 2018

-3°C | +5°C

15 DEN

## AKTUALE

Rasti i Almiriit procedohet në bazë të ligjit



Protesta qytetare e mbajtur të hënën në Shkup kundër rrjedhës së deritanishme të procesit gjyqësor kundër Boban Iliqit, vrasësit të vogëlushit nga Kumanova, Almir Aliu, ka ndikuar që së fundmi të prononcohet edhe kryeprokurori i shteti, Lubomir Jovevski. Përmes një letre publike, kryeprokurori i ri i zgjedhur javë më parë, apelon...

Fq.5

## FORUM

Si e ndaluan Amerikanët gjenocidin në Ballkan

Fq.10

## MOZAIK

Kanceri në tru shërohet me viruse

Fq.13

## GLOBI

Hebrenjtë e padëshiruar të Francës

Fq.15



## LASH-i I SHKUPIT DHE KUMANOVËS ME VËREJTJE

# 55 MINUTAT SHUMË LARG REALITETIT



Sipas kryetarëve të këtyre dy organizatave, Nuhi Dardhishta dhe Etem Xheladini, është krejt diçka tjetër të synosh reforma dhe krejt tjetër të gjes rrugën e duhur. Dhe, ajo që është më e rëndësishme, reforma apo model i ri i shkollimit duhet të përshtatet me kushtet reale të sistemit arsimor

Fq.6

## Hajnat e xhamive

Tetovë, 23 janar - Kohëve të fundit sërish në skenë kanë dalë hajnat nëpër objektet fetare. Pas vjedhjes në Xhaminë në Reçicë të vogël, cak i hajnave kanë qenë Xhamia e Pashës në Tetovë dhe xhamia e “Rinisë” në rrugën 176 në lagjen e Vardarskës. Nga Këshilli i kësaj xhamie theksuan se hajnat kanë arritur të hyjnë brenda, por jo edhe të marrin diçka. Personat përgjegjës në këtë xhami në Tetovë thonë se di-

sponojmë me pamjet nga akti i hyrjes së hajnat në xhami përmes kamerave të sigurisë. Ramadan Tahiri, kryetar i Këshillit të xhamisë thekson se ky është tentimi i tretë për vjedhje, por hajnat kanë dështuar, sepse është aktivizuar menjëherë alarmi. “Ky është tentimi i tretë apo i katërt për të vjedhur në këtë xhami, por fatmirësisht për shkak të mbulimit të mirë me kamera dhe alarm, në dy herët...”

Fq.9



EDITORIAL

# LEGJENDAT KOMITE



Emin AZEMI

Një pjesë e juristëve edhe intelektualëve maqedonas, mendojnë se Ligji për përdorimin e gjuhëve, nuk buron nga nevojat dhe prioritetet e qytetarëve dhe e shoqërisë, sepse, sipas tyre kjo çështje është rregulluar me Kushtetutë dhe me ligjin paraprak që rrjedh nga Marrëveshja e Ohrit. Ky mendim bazohet në një bindje të përhapur në shoqërinë maqedonase se bëhet fjalë për marrëveshje politike që duhej të arrihej si kusht për mbijetesën e koalicionit qeverisës. Çështja e gjuhës është materie e pastër kushtetuese-ligjore dhe si e tillë duhej të votohej me dy të tretat e Kuvendit, për t'u konsideruar i miratuar. Ky është shkaku që Ligji për përdorimin e gjuhëve mund të nxisë iniciativa drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Kështu mendojnë juristët dhe intelektualët maqedonas, të cilët nuk ngurrojnë ta kualifikojnë këtë materie si "tirani të pakicës". Sipas tyre çështja e gjuhës shqipe ka hapur shumë dilema për vetë karakterin e shtetit të Maqedonisë dhe si e tillë po imponon njëfarë tiranie të pakicës kundrejt shumicës, me çka unitariteti i shtetit po vihet seriozisht në pikëpyetje.

Në Maqedoni ende përdoret fjala "tirani" kur janë në pyetje të drejtat universale të një populli. Si duket, mendësia e atyre që e parapëlqejnë këtë sintagmë, nuk është liruar ende nga e kaluara kur maqedonishtja vuante peshën e injorimit dhe përbuzjes nga qeveritë despotike të karagjorgjeviqëve e pashiqëve. Realiteti i ri, i një Maqedonie postkaragjorgjeviqiane, në të cilën shqiptarët janë faktor jo vetëm demografik, por edhe politik, ekonomik, kulturor e social, ka krijuar papërputhshmëri në mes të vizionit të ri evropian që e synojnë të gjithë qytetarët e arsyeshëm dhe, atyre që muskujt trunor i ushqejnë me legjenda komite.

Ky deformim i qëllimshëm i një problematike që rregullon barazinë e qytetarëve brenda një shteti, mund të ketë ithtarë në atë pjesë të shoqërisë maqedonase e cila ende ka si infuzion shpirtëror adrenalinën nacional-romantike të injektuar nga partia pararendëse që ishte në pushtet. Ky nuk është problem i vogël për këtë komunitet njerëzish, sado që të jetë numri i tyre, për arsye se ata ende nuk po gjejnë shpjegim për faktin se Maqedonia nuk është vetëm e maqedonasve, por e gjithë atyre që jetojnë në të.

Teoritë jacobine për shtete e shoqëri të pastra, ku çështja e gjuhës dhe kombit është në një kohezion jopërrjashtues, në Maqedoni edhe sot mësohen si përralla për të vënë në gjumë fëmijët e lodhur nga traumat historike të shekullit 19.

Vijimësia dhe kompaktësia territoriale e shqiptarëve të Maqedonisë, bashkë me autoktonësinë dhe identitetin e tyre dallues social-linguistik e etno-psikologjik, do të duhej të jenë shenja dalluese të një alfabeti civilizues për të gjithë ata që nuk e kanë të qartë peshën dhe rolin e faktorit shqiptar në Maqedoni.

Për të qenë situata edhe më tragjikomike, Maqedonia po të bazohej në sensibilitetet nacional-romantike të komitaxhinjëve, nuk do të qëndronte as edhe një orë në këmbë të shëndosha, po të mos ishin shqiptarët si faktorë garantues në stabilitetin dhe sovranitetin e pacenuar të saj.

E pakta që shqiptarët mund të kenë mirëkuptim për ato mjedise të pastra maqedonase, është jodomosdshmëria e pjesëtarëve të saj për ta përdorur gjuhën shqipe nëse ajo vërtetë nuk iu hyn në punë dhe nëse nuk paraqitet ndonjë shqiptar në cilësinë e një personi fizik a juridik, i cili përpos maqedonishtes ka nevojë ta flet dhe shkruan edhe shqipen. Të gjitha përrallat tjera për unitaritetin e shtetit mund t'iu ngjasojnë mëlmesave për një çorbë bajate komitaxhuinjësh.

## MAQEDONIA JASHTË "INTERMARIUMIT"

"Maqedonia aktualisht gjendet jashtë 'Intermariumit' që po zhvillohet në Evropën Lindore. E vetmja situatë që do të shkonte në favor të Kremlinit, do të ishte destabilizimi i Maqedonisë nga brenda dhe për këtë, qeveria e kryeministrit Zoran Zaev duhet t'i përfundojë reformat dhe t'i zgjidhë problemet ndëretnike. Rusia në planin rajonal do të vazhdojë të tregojë interesim për Ballkanin edhe gjatë dekadës së tretë. Skenari më i keq për Maqedoninë dhe Ballkanin do të ishte në rast se, do të kemi ndonjë ndryshim radikal në sistemin ndërkombëtar e cila do të prodhonte një rend të ri gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari Selim Ibraimi.



## KUR VLON KOMUNA E ÇAIRIT

"Komuna e Çairit vlon, ama bukualisht vlon nga parregullsitë në komunikacion, vrasjet e shpeshitume, huliganizmi, fukarallëku, parregullsia, degjenerimi ambiental, shkollimi i shkallzum deri në fanatizëm teposhtë, varshmëria dembele e patologjike tanimë nga paratë e shqipëve që ikin masivisht jashtë vendit, shëndetësia që zhvillohet në kushtet e kohës se Federatës YU, çajtoje me burra plot e gra asnjë, xhamia me jobesimtarë - ilegale e jolegale, kisha e xhamia legale të ndërtime pa hesap, shkolla me oborre të uzurpuara për biznes larje makinash, e populluar si honet e bletëve një mbi një, me lagje pa kanalizim... (doni më), ndërsa këshilltarët e kësaj komune lëshojnë seancën sepse njëri grupacion ndjehet i persektuar ndërsa tjetri i tradhtum nga vetvetja! E mendoja sot, a ishte më mire kur rebelohesha ose kur kam kaluar në indiferencë! Pa ndryshim! Si ti ndihmojmë kësaj Komune... si të qytetarizojmë aktivizmin për të mirën e komunës... fëmijëve. Miq, po humbim beteja jete nga huliganizmi politik, papjekuria, shkurtpamësia... Çka është ajo që 95 për qind e popullatës së kësaj komune që janë votues të thjeshtë i bën të ndjehen mirë kur abstenojnë nga e drejta për jetë më të mirë për veten e në emër të ruajtjes së privilegjeve të atij 5 përqindëshi liderësh që merren me politikë në këtë komunë, e që janë të partive të ndryshme politike...!? Tanimë janë pjekur kushtet vërtetë mirë për analizë sociologjike me qëllim që të ndërtojmë politikë shpëtuese për një jetë më të mirë tonën këtu ku jemi... e më mirë mos qofshim - si i thonë!", shkruan publicistja Adelina Marku.



## MEDIA Citate

Në takimin me degën 11 të Laprakës, në Tiranë, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, tregoi gjendjen e rëndë ekonomike duke iu referuar historisë së dhimbshme publike të një babai, i cili ditën që nuk kishte gjetur punë tek "Ushtari i Panjohur", kishte shitur gjak për të blerë bukën e fëmijëve. "Gjendja e atij kryefamiljari është gjendja e mijëra prindërve shqiptarë, e 290 mijë shqiptarëve. Mjerim absolut. Nuk arrijnë dot të blejnë bukën e gojës për fëmijët e tyre. Po si mund t'i thotë vetes kryeministër, që shikon këtë gjendje dhe e zgjidh qesen, për çfarë? Për 400 milionë lek makina", u shpreh Basha.

(Gazeta Shqip, 23 janar)

Kryeministri Edi Rama do të takohet me homologun grek Aleksis Tsipras në Davos të Zvicrës.

"Unë do të takohem me kryeministrit grek në ditët në vijim, pasi do të jemi të dy bashkë në Davos, por njëkohësisht mbetet edhe një fazë tjetër e saktësisht të gjithë elementëve që kanë të bëjnë me marrëveshjen e arritur në linja të gjera", tha Rama.

Duke konfirmuar këtë takim në emision "5 pyetje nga Babaramo", kryeministri tha se detajimi i marrëveshjes do të behet në dokumente që do të marrin lëre ligjore apo të një platformë të re të partneritetit strategjik.

(Top Channel, 23 janar)

Zëdhënësi i Presidencës së Turqisë, Ibrahim Kalin, tha se Turqia nuk ka sjellë lot, gjakderdhje dhe persekutime në asnjë vend ku ka zhvilluar operacione.

"Turqia nuk ka sjellë lot, gjakderdhje, persekutim në asnjë vend ku ajo ka qenë e pranishme me operacionet e saj. Përkundrazi, në çdo territor ku vendi ynë ka vendosur këmbën, njerëzit jetojnë në paqe dhe harmoni. Rajoni i operacionit 'Mburoja Euftratit' është shembulli më konkret i kësaj", tha Kalin në një deklaratë me shkrim pas një takimi të sigurisë në Rezidencën Presidenciale në Ankara, duke iu referuar operacionit "Dega e Ullirit" që Turqia është duke e realizuar kundër elementeve terroriste në Afrin të Sirisë.

(Anadolu Agency, 23 janar)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## ÇFARË ISHTE MEMORANDUMI I SHKODRËS?

Memorandumi i Shkodrës (13 qershor 1878) ishte dokument i hartuar nga një grup patriotësh në Shkodër, dërguar kryeministrit britanik Bikonstild ditën e hapjes së Kongresit të Berlinit. Memorandumi i Shkodrës tërhoqte vëmendjen e Fuqive të Mëdha të kohës mbi ekzistencën edhe të një çështjeje shqiptare në kuadrin e krizës lindore të viteve 1875-1881, denonconte Traktatin e Shën Stefanit, afirmonte identitetin kombëtar të

popullsisë shqiptare në trevat e banuara prej tyre nga veriu në jug. Memorandumi u bënte thirrje Fuqive të mbledhura në Kongresin e Berlinit për të njohur e përkrahur të drejtat e shqiptarëve, për të trajtuar të ardhmen e Shqipërisë si një element të domosdoshëm të ekuilibrit dhe paqes në Ballkan. Në të u hodh edhe ideja e shkëputjes së Shqipërisë nga Turqia dhe e pavarësisë së saj.



## HOXHAI-ZAEV, KOORDINIM PËR MBLEDHJE TË PËRBASHKËT QEVERTARE

Pas takimit me Zaevin, Hoxhaj tha se ndër pikat kryesore gjatë mbledhjes së përbashkët ndërqeveritare, e cila më gjasë do mbahet në mars, do të jetë lehtësimi i procedurave në kufi, hapja e pikës së re kufitare bellanoc-Stançiq, si dhe autostrada nga qarkorja e Shkupit deri në Bllacë



## KOSOVA DO TA KONKRETIZOJË BASHKËPUNIMIN ME SHKUPIN

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 23 janar - Zëvendëskryeministri i Kosovës për çështje evropiane, Enver Hoxhaj, të martën në pati takim me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev, për të koordinuar aktivitetet për organizmin e mbledhjes së përbashkët qeveritare mes të dyja vendeve. Zëvendëskryeministri Hoxhaj tha se ndër pikat kryesore do të jenë lehtësimi i procedurave në kufi, hapja e pikës së re kufitare Stançiq-Bellanoc dhe ndërtimi i autostradës në pjesën e Maqedonisë, nga qarkorja e Shkupit deri në Bllacë. "Pas vizitës në Kosovë dhe takimit që kishte Zaev me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që unë të jem koordinator për organizmin e mbledhjes së përbashkët qeveritare. Prandaj e takova kryeministrin Zaev, ministrin për Diasporë dhe shefin për Politikë të Jashtme në kryeministri dhe diskutuam për atë se si në një kohë sa më të afërt - të organizojmë mbledhje të përbashkët qeveritare. Pas kësaj mendoj se duhet të ketë një deklaratë të përbashkët ku fokusi kryesor do të jetë bashkëpunimi rajonal sidomos ai ekonomik, tregtar dhe bashkëpunim më i madh mes të dy shoqërive tona", tha për mediat zëvendëskryeministri kosovar, Enver Hoxhaj. Ai përmendi muajin mars si më të mundshmin për mbledhje të përbashkët, por pa precizuar

ende ndonjë datë të caktuar.

"Ende nuk kemi ndonjë datë të caktuar, por mendojmë të jetë diku nga marsi. Deri atëherë do të kemi mjaft kohë që marrëveshjet të cilat i kemi diskutuar deri më tani - ti finalizojmë. Duhet të kemi një strategji të përbashkët se cilat tema do të trajtohen. Ne mendojmë se lëvizja mes njerëzve duhet të jetë më e thjeshtë, procedurat në kufi duhet të jenë më të thjeshta, duhet të hapet pika kufitare Stançiq-Bellanoc, jemi të interesuar që të fillojë të ndërtohet autostrada në pjesën e Maqedonisë, meqë ne në Kosovë përfundojmë segmentin Han i Elez-it-Prishtinë. Duhet të ketë bashkëpunim sa më të madh ekonomik, edhe tregtar edhe kulturor edhe

arsimor. Ndonëse nga Qeveria nuk kishte asnjë lajmërim për vizitë zyrtare dhe në agjendën zyrtare të kryeministrin Zaev nuk ishte paraparë asnjë takim me zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj, ky i fundit tha para mediave se takimi ishte ndërtimi i autostradës ka qenë i parashikuar që të dyja vendet të mbarojnë atë në vitin 2018, Maqedonia për dallim nga Kosova që pret përrimin e saj, ende është në fazën e fizibilitetit dhe riprojektimit. Në Buxhetin 2018, Qeveria e Maqedonisë ka paraparë mjete për riprojektim, ndërsa ndërtimi do të fillojë tek në vitin 2019. Sipas asaj që ka thënë ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugarevski më

28 dhjetor të vitit të kaluar gjatë seancës për pyetje të deputetëve, pritjet e tij janë që "në fund të këtij viti ose në fillim të vitit 2019 të fillojë ndërtimi i autostradës Shkup-Bllacë, për të cilin projekt bëhet riprojektim që të shmangen problemet të cilat janë paraqitur gjatë ndërtimit të autostradave vijuese". Ndërkaq i njëjti tha se vetëm për sanimin e rrugës deri në nisjen e ndërtimit në buxhetin vitit 2018-ët janë paraparë 3 milionë euro. Sa i përket pikës kufitare Stançiq-Bellanoc, për dallim nga Kosova që kishte përfunduar ndërtimin e rrugës tre vite më parë, Maqedonia është vonuar dhe tek në verë të vitit e kaluar ka përfunduar segmentin rrugor Sllupçan-Stançiq.

### POTENCIAL PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT

Zëvendëskryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, realizoi takim me Zëvendëskryetarin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj. Njëra nga temat kryesore të takimit ishte shkëmbim i mendimeve dhe informatave në drejtim të organizimit të seancës së përbashkët Qeveritare mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës. "Shkupi dhe Prishtina nuk kanë çështje të hapura politike, që paraqet potencial për thellimin e marrëdhënieve mes dy Qeverive", theksoi Osmani në takim. Ai shtoi se udhëheqësit shtetëror detyrimisht duhet japin kontribut më të madh, për të përmirësuar kushtet për shkëmbim dhe komunikim, me qëllim që të mbështesin potencialin gjithnjë e më të madh të biznesit, por edhe nevojën e qytetarëve të dy vendeve për komunikim më të lehtë të ndërsjellë. "Marrëdhëniet

tona të shkëlqyera së shpejti do ti demonstrojmë edhe me mbajtjen e seancës së përbashkët Qeveritare mes dy vendeve, nga ku pres të dalin iniciativa, masa dhe aktivitete konkrete, në drejtim të thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë", theksoi Osmani. Dy bashkëbiseduesit edhe një herë potencuan angazhimin e dy vendeve për perspektivën evropiane të rajonit, e cila është në interes të të dy vendeve që në mënyrë të ndërsjellë të mbështesin njëri-tjetrin në procesin e integritetit të BE-së. "Maqedonia, ka fituar përvojë të jashtëzakonshme përmes aktiviteteve shumëvjeçare në kuadër të procesit për Stabilizim dhe Asociim me Bashkimin Evropian, dhe me kënaqësi, këta përvoja do ti transmetojë kolegëve nga Kosova, dhe me qëllim të përshpejtitimit dhe avancimit të perspektivave evropiane të gjithë rajonit", theksoi Osmani.

## Zaev në Davos, në fokus takimi i parë me Ciprasin

Davos, 23 janar - Përforsim i marrëdhënieve midis të dy vendeve në kontekst të ndërtimit të masave të besimit në periudhën e kaluar, si dhe analizë të së aritursës së deritanishme në negociatat e ripërtëritura midis Maqedonisë dhe Greqisë për çështjen për emrin, do të jenë në fokusin e takimit të sotëm (e mërkurë) të parë të drejtpërdrejt të kryeministrin Zoran Zaev me kolegun e tij grek Aleksis Cipras, i cili do të mbahet në margjinat e Forumit Ekonomik Botëror në Davos. Zaev nga sot e deri më 26 janar do të marrë pjesë në Forumin e sivjetmë ekonomik botëror në Davos, Zvicër, në të cilin këtë vit marrin pjesë shefat e shteteve dhe qeverive, përfaqësues të tjerë shtetëror, si dhe liderët e kompanive më të mëdha në botë. Zaev, siç njoftoi Qeveria, do të ketë takim edhe me eurokomisararin për Politikë Fqinjësore dhe Zgjerim Johannes Han. Takimi është planifikuar për të premtën. Të njëjtën ditë në agjendën e kryeministrin Zaev është edhe takimi me drejtoreshën për Evropë të Forumit Ekonomik Botëror, Martina Larkin. Gjatë Forumit Ekonomik Botëror në Davos, kryeministri Zaev do t'i ndjekë fjalimet speciale të Emanuel Makronit, presidenti i Francës, Zhan Klod Juncker, kryetar i Komisionit Evropian, Tereza Mej, kryeministre e Britanisë së Madhe, Benjamin Netanjahu, kryeministër i Izraelit, dhe kancelares gjermane Angela Merkel. Kryeministri Zaev do të marrë pjesë në panel diskutime dhe takime pune me liderë ekonomik nga bota dhe me mysafirë të tjerë të lartë nga rajoni, BE-ja dhe SHBA-ja. Gjatë qëndrimit në Davos, Zaev do të ketë edhe disa takime të tjera pune dhe takime bilaterale me investues potencialë, biznes liderë dhe bashkëpunëtorë.

## AMBASADORI BULLGAR PREZANTON PRIORITETET E KRYESIMIT ME BE-NË



Athinë, 23 janar - Çështja për emrin është midis Shkupit dhe Athinës, Bullgaria nuk mund të ketë rolin e ndërmjetësuesit, konsideron ambasadori bullgar në Greqi, Veslin

## Shkupi dhe Athina mund të gjejnë zgjidhje

Ivanov, i cili në zyrën e delegacionit të Parlamentit Evropian në Athinë i prezantoi prioritetet e kryesisë bullgare me BE-në. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, kontesti me emrin dhe perspektiva evropiane për Ballkanin Perëndimor, Veselin Ivanov i konfirmoi si pjesë të prioritetëve të larta të kryesimit të Bullgarisë me BE-në. Me qëndrim identik se Bullgaria është vetëm vend kryesues me BE-në dhe nuk është pjesë e negociatave midis Maqedonisë dhe Greqisë doli

edhe shefi i diplomacisë greke Nikoz Koxias. Duke iu përgjigjur pyetjes të gazetarëve, nëse kryesimi bullgar si vend ballkanik mund të ndihmojë apo t'i lehtësojë negociatat, Koxias tha se negociatat zhvillohen midis dy vendeve. Relacionet Shkup-Sofje-Athinë në bisedë me korrespondentin e MIA-s nga Athina i komentoi pikërisht ambasadori bullgar, i cili tha se është optimist se Maqedonia dhe Greqia do të gjejnë zgjidhje të problemit. Në pyetjen për rolin, që Bullgaria, si

vend aktual kryesues do ta ketë në negociatat për kontestin me emrin, por edhe lidhur me integrimin evropian në Maqedoni, Ivanov theksoi se Sofja dëshiron që të gjejë zgjidhje. "Siç thashë edhe në paraqitjen tonë, një nga prioritetet e Ballkanit Perëndimor, më konkretisht zgjidhjen e çështjes me emrin me Greqinë, prandaj që këtu rrjedh edhe prosperiteti i vendit tuaj. Duke e ditur që prej këtu varet hyrja në NATO, në BE dhe ne me zemër dëshirojmë që të gjendet

zgjidhje. Për këtë zgjidhje, mendoj se ka dëshirë tek qeveritë e të dy vendeve që të arrihet konsensus. Ne ndihmojmë që të gjendet mënyrë për të gjetur zgjidhje", theksoi ambasadori bullgar. Ai përmendi se edhe pse Bullgaria nuk mund të jetë mediator, megjithatë mund të ndihmojë në këtë proces. Ai pozitivisht iu përgjigj pyetjes nëse nënshkrimi i marrëveshjes midis Maqedonisë dhe Bullgarisë mund të jetë shembull për zgjidhjen e problemit.

Nga dy ankande të letrave më vlerë, realizuar vetëm në muajin janar, borxhi i brendshëm është rritur për 100 milionë euro, ndërsa me emetimin e euro-obligacionit në tregun e jashtëm, në vlerë prej 500 milionë eurove, borxhi i publik është rritur për 600 milionë euro, duke arritur vlerën totale të borxhit publik në rreth 5 miliard euro, nga 4.6 miliard euro sa ishte në muajin shtator të vitit 2017

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 23 janar - Vetëm në muajin e parë të këtij viti, Maqedonia ka rritur borxhin publik për rreth 600 milionë euro. Ministria e Financave në tregun vendor në ankandin për letra me vlerën nga e marta ka hyrë në borxh të ri, duke marrë rreth 24 milionë euro nga bankat vendore dhe kompanitë e sigurimit. Ndërkohë dy javë më parë, më 9 janar të këtij viti, në tregun vendor po ashtu u emetuan letra me vlerë dhe nga bankat vendore u grumbulluan mbi 73 milionë euro. Nga dy ankande të letrave më vlerë realizuar vetëm në muajin janar borxhi i brendshëm është rritur për 100 milionë euro, ndërsa me eme-

BORXHE TË REJA NË TREGUN VENDOR

# VETËM PËR 1 MUAJ, 100 MILIONË EURO



timin e euro obligacionit në tregun e jashtëm në vlerë prej 500 milionë eurove, borxhi i publik është rritur për 600 milionë euro, duke arritur vlerën totale të borxhit publik në rreth 5 miliard euro, nga 4.6 miliard euro sa ishte në muajin shtator të vitit 2017.

Marrjen e borxheve të reja në tregun vendor, nga Ministria e Financave e arsyejnë me faktin se futja në borxhe të reja bëhet për shkak të kthimit të borxheve të vjetra, gjegjësisht në tregun vendor deri në fund të muajit janar shteti duhet të kthejë borxh të vjetër në vlerë prej 24 milionë euro. Për 11

muajt e parë të vitit 2017, Ministria e Financave nga emetimi i letrave më vlerë në tregun e bankar ka rritur borxhin shtetëror për 10 për qind dhe me emetimin e dy ankandëve të reja të letrave më vlerë në muajin janar, Ministria e Financave ka rritur borxhin shtetëror në 1.459 miliard euro. Njëherësh me emetimin e euro-obligacionit, po në muajin janar, në vlerë prej 500 milionë euro dhe borxhit të ri në tregun vendor në vlerë prej mbi 100 milionë euro, borxhi publik i Maqedonisë ka tejkaluar shifrën prej 5 miliard euro.

Me marrjen e borxhit të ri në

tregun ndërkombëtar financiar nga viti 2005, nëpërmjet këtij instrumenti, Maqedonia ka marrë borxh të përgjithshëm në vlerë mbi 2 miliardë euro, pa llogaritur kamatat. Deri më tani në tregun ndërkombëtar financiar janë emetuar 6 euro-obligacione, ndërsa Maqedoni deri më sot ka arritur të kthejë borxhin e dy euro obligacioneve të vitit 2005 dhe 2009, në vlerë të përgjithshme prej 245 milion eurosh përfshirë dhe kamatat. Ndërsa për katër euro obligacionet e mara në vitin 2014, 2015, 2016 dhe 2017, Maqedonia duhet të kthejë edhe 1.6 miliard euro deri në fund të vitit 2020. Me euro obligacionin më të ri në vlerë prej gjysmë miliardi eurosh Maqedonia po ashtu deri në fund të muajit janar do të paguaj 95 milion euro, gjegjësisht një pjesë të borxhit të euro obligacionit të emetuar në vitin 2014 në vlerë prej 500 milionë eurosh. Pjesa tjetër e parave nga euro obligacioni i ri prej 500 milionë euro, sipas Ministrisë së Financave do të përdoren për mbulimin e deficitit buxhetor dhe për realizimin e disa projekteve infrastrukturore, të parapara me buxhetin e vitit 2018.

## 77 për qind e qytetarëve nuk e dinë se ekziston procedura VNR

Shkup, 23 janar - Më shumë se 77 për qind e qytetarëve asnjëherë nuk kanë dëgjuar se ekziston procedurë që quhet "Vlerësim i ndikimit të rregullativës" (VNR), ndërsa 72 për qind e të punësuarve në sektorin shtetëror nuk kanë dëgjuar fare për (VNR) edhe pse administrata shtetërore është një nga mjetet kyçe për zbatimin e tij. Këtë e theksojnë rezultatet nga hulumtimi i opinionit publik për perceptimin e opinionin lidhur me VNR të zbatuar nga Instituti për demokraci "Societas Civilis" (IDSCS) dhe Qendra për analiza ekonomike (QAE) mbi ekzemplarin nacional prej 1.000 të anketuarve në periudhën prej 20 shtatorit deri në 20 tetor të vitit 2017. Sondazhi i terreni është përpunuar në kuadër të projektit "Vlerësim i ndikimit të rregullativës në hije: promovim dhe krijim i politikave të bazuara në dëshmi", buxheti i së cilës arrin 332 mijë euro nga të cilat 299 mijë janë mbështetje financiare nga BE-ja, që zbatohet nga janari i vitit 2017 dhe do të zgjat deri në dhjetor të vitit 2019. Çdo i dyti i anketuar, theksoi Jane Dimeski nga IDSCS në takimin e sotëm me gazetarë, konsideron se Qeveria dhe Kuvendi nuk miratojnë ligje të reja, ndërsa pjesa më e madhe e të anketuarve konsiderojnë se VNR duhet t'i hetojë edhe ndikimet ekonomike dhe sociale të ligjeve të reja.

## LSDM mund të parashtrijë amendamente për Ligjin e shqipes

Shkup, 23 janar - Deputetët e LSDM-së deri nga fundi i javës do të marrin vendim nëse do të propozojnë amendamente për Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ata ende e shqyrtojnë propozimin e presidentit Gjorge Ivanov, i cili i përmban vërejtjet në 14 faqe. "Vërejtjet e presidentit Ivanov i morëm dje vonë pa-

sdite. Si deputetë na duhet kohë që t'i shqyrtojmë vërejtjet e tij dhe sugjerimet dhe deri nga fundi i javës do të mbajmë koordinim ku do të vendosim si do të veprojmë dhe do ta marrim qëndrimin tonë përfundimtar", deklaroi zëvendës koordinatori i grupit të deputetëve të LSDM-së, Jovan Mitrevski. Lidhur

me kërkesën e VMRO-DPMNE-së, megjithatë, për formimin e grupeve të punës për ligjin për përdorimin e gjuhëve, Mitrevski thotë se partia opozitare edhe gjatë periudhës së kaluar dhe tani kur ligji është kthyer në lexim të tretë, ka mundësi të parashtrijë amendamente dhe përmes debatit të

amendamenteve të korrigojohet teksti. Nga grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së thonë se formimi i grupeve punuese për ligjin për gjuhët nuk do të thotë edhe pjesëmarrje të deputetëve të tyre në punën e Parlamentit, por ky do të jetë hap i mirë edhe sinjal pozitiv për dialogun politik në Kuvend.

## LSDM kërkon 33 për qind shpenzime më të vogla rrugore, Ademi ankohet për sulme

Shkup, 23 janar - Anëtarët e Komisionit parlamentar për punë dhe politikë sociale të martën unanimitisht i votuan ndryshimet e Ligjit për rrugë dhe kompensime tjera të personave të përzgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë, me të cilat parashikohet ulje e mjeteve për shpenzime rrugore për 33 për qind të deputetëve dhe personave tjerë të emëruar dhe të zgjedhur. Deputetja e BDI-së, Mirsada Emini-Asani, votoi pro ligjit, edhe pse kolegu i saj partiak, Xhevat Ademi, paralajmëroi se, si provokim, do të kërkojë pezullim të plotë të



shpenzimeve rrugore për të gjithë funksionarët dhe se deputetët me vite kanë qenë në sulm të gazetarëve si fajtorë të përhershëm. "Nuk mundet deputetët të jenë


fajtorë të përhershëm kur kemi funksionarë anonimë, të cilët nuk dinë se çfarë beneficione kanë. Do të parashtrijë amendament për pezullim të plotë të shpenzime-

ve rrugore, kështu që deputetët le të organizohen dhe le të vijnë në punë me taksë apo me ndonjë transport tjetër", tha Ademi, sipas të cilit deputetët nga më shumë përbërje kanë qenë në shënjestër për këtë punë. Ai theksoi se nuk ka dëgjuar që ndonjë ministër apo drejtor anonim është kritikuar për atë se sa shpenzime rrugore ka bërë apo ka shpenzuar mjete tjera. Sipas Ademit, nevojitet plotësisht Ligji i ri, i cili siç tha ai, do ta heq këtë "temë të përhershme", e cila është "sulm mbi deputetët". Jovan Mitrevski, kryetar i Komisionit për punë dhe politikë sociale,

potenoi se me zgjidhjen e tyre do të ulen mjete për shpenzime rrugore të deputetëve nga 30 deri në 20 për qind, respektivisht për 33 për qind dhe se kjo është zgjidhje afatshkurte. "Mbetemi të hapur për të gjitha propozimet për gjetjen e zgjidhjes afatgjate", tha Mitrevski. Ndryshimet e propozuara e përfshijnë edhe Ligjin për deputetët që është nesër në seancën e Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie mes bashkësive, ndërsa propozimi në rend dite është vendosur në seancën plenare të caktuar për të hënë.

KRYEPROKURORI THYHEN HESHTJEN, ME LETËR I DREJTOHET OPINIONIT

# JOVEVSKI SIGURON: RASTI I ALMIRIT PROCEDOHET NË BAZË TË LIGJIT



Ndonëse provat materiale dhe dëshmitë publike në rastin e vrasjes së vogëlushit Almir Aliu, nuk duan ndonjë analizë më të detajuar për të vërtetuar fajësinë e vrasësit Boban Iliq, megjithatë për më tepër së një vit e gjysmë ky proces po zvarritet. Pala mbrojtëse dhe familjarët e prekur nga kjo vrasje janë të bindur se prolongim i këtij gjykimi bëhet me qëllim rikualifikimin e veprës penale

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 23 janar - Protesta qytetare e mbajtur të hënën në Shkup kundër rrjedhës së deritanishme të procesit gjyqësor kundër Boban Iliqit, vrasësit të vogëlushit nga Kumanova, Almir Aliu, ka ndikuar që së fundmi të prononcohet edhe kryeprokurori i shteti, Lubomir Jovevski. Përmes një letre publike, kryeprokurori i ri i zgjedhur javë më parë, apelon që të ndalohen presionet, siç thotë ai, të partive politike, të cilët janë shpeshuar ditëve të fundit. Politika, siç thotë ai në këtë letër, nuk duhet të përzihet në punën e prokurorisë. Tutje, ai nënvizon se kolegët e tij punën e tyre e kryejnë me profesionalizëm dhe se çdo vendim i cili do të miratohet, i njëjti do të mbështetet në dispozitat ligjore dhe provat e parashtruara.

"Me ardhjen time në krye të Prokurorisë Publike të Maqedonisë, u betova se të gjitha vendimet nuk do të miratohet në bazë

të dëshirave dhe shtabeve partiake apo qendrave tjera me ndikim. Kthimi i besueshmërisë në këtë institucion dhe profesionalizmi janë parimet bazë mbi të cilën e mbështes këtë funksion përgjegjës. Partitë politike, pa dallim se a janë në pozitë apo opozitë, pa dallim të përkatësisë etnike, u pajtuan se do t'i largojnë duart nga ndikimi mbi Prokurorinë, do ta respektojnë pavarësinë e saj dhe se do të angazhohen për reforma të vërteta në sistemin juridik vendas. Për këto shkaqe, kërkojë që edhe në rastin i cili ditëve të fundit është aktual në opinion, ata të veprojnë në pajtim me parimet e tyre deklarative dhe qëndrimet e shprehura publikisht", thotë kryeprokurori Jovevski.

Ndonëse provat materiale dhe dëshmitë publike në rastin e vrasjes së vogëlushit Almir Aliu, nuk duan ndonjë analizë më të detajuar për të vërtetuar fajësinë e vrasësit Boban Iliq, megjithatë për më tepër së një vit e gjysmë

ky proces po zvarritet. Pala mbrojtëse dhe familjarët e prekur nga kjo vrasje janë të bindur se prolongim i këtij gjykimi bëhet me qëllim rikualifikimin e veprës penale. Lidhur me këtë çështje, kryeprokurori Lubomir Jovevski, në deklaratën e tij publike thotë se e bind opinionin se ngjarja tragjike, në të cilën e humbi jetën katërvjeçari Almir Aliu, nga ana e Prokurorisë Publike shqyrtohet në mënyrë jo-selektive, të paanshme dhe profesionale, ashtu siç e kërkon ligji.

Komentet dhe vlerësimet mbi këtë ngjarje juridiko-penale, sipas kryeprokurorit Jovevski, duhet të bëhen në bazë të dëshmiave dhe fakteve nga e gjitha ngjarja. Ai vlerëson se vetëm mbi një analizë të plotë të dëshmiave mund të vërtetohet e vërteta materiale dhe përgjegjësia penale. Ndryshe, në fund të letrës publike, kryeprokurori Lubomir Jovevski edhe një herë ju adresohet subjekteve politike, ku ju rekomandon se në rast të dyshi-

meve që ato mund t'i kenë mbi punën e tij apo vërejtjeve për aspektin profesional, të njëjtit mund të iniciojnë procedurë për shkarkimin e tij nga kjo pozitë. Sidoqoftë, deklaratën e parë publike ky kryeprokuror ka zgjedhur ta bëjë përmes një letre dhe jo duke u ballafaquar me opinion dhe mediat në konferencë për shtyp, ku mes tjerash shton se kryerësit e veprave penale nuk do të trajtohen në bazë të përkatësisë etnike apo partiake, por enkas në bazë të dëshmiave.

Nga ana tjetër, seanca gjyqësore e radhës për vrasjen e Almir Aliut, e cila duhej të mbahet të martën me 23 janar, u prolonguan për datë 6 shkurt. Avokati i familjes Aliu, Asmir Alispahiç, tha se anulimi i kësaj seance është bërë për shkaqe subjektive. Në këtë seancë e cila u anulua prezent ishte edhe vrasësi Boban Iliq, i cili për momentin qëndron në paraburgim në burgun e Kumanovës.

## KRONIKË

### Dy bullgarë lëndohen në Kriva Pallankë

Dy shtetas bullgarë F.F.V. (47) dhe V.K.A. (26), të cilët kanë qenë bashkudhëtarë në automjetet, janë lënduar rëndë në një aksident që ka ndodhur në rrugën magjistrale Kriva Pallankë-vendkalimi kufitar "Deve Bair". Siç informoi sot MPB-ja, aksidenti ka ndodhur dje në orën 1:15. Në aksident E.E.K. (27) nga Republika e Bullgarisë, duke drejtuar automjetin "Audi 4" me targa kombëtare bullgare, ka humbur kontroll dhe ka goditur në sipërfaqen e tokës në shtratin e lumit të Kriva Rekës. F.F.V. (47) dhe V.K.A. (26) u është dhënë ndihmë mjekësore në Shtëpinë e shëndetit-Kriva Pallankë, ndërsa pas kërkesës së tyre janë nisur për kurim të mëtejshëm në Republikën e Bullgarisë. Pas autorizimit të prokurorit publik, ekspertizë në vendin e aksidentit ka realizuar ekip nga Stacioni policor në Kriva Pallankë.

### Shkupjani kërcënon tetovaren në Instagram

26 vjeçarja A.F të hënën mbrëma rreth orës 22 ka denoncuar shantazh nga 24 vjeçari Xh.Z nga Radishani i Shkupit me të cilin në dhjetor të vitit të kaluar përmes Instagram ka filluar të kontaktojë. I denoncuari shpesh herë e ka kërcënuar se do ta shkatërrojë atë dhe familjen e aj nëse nuk i dërgon fotografi intime.

Duke u frikësuar për sigurinë e saj ajo i ka dërguar një fotografi dhe më pas ai e ka kërcënuar se nëse nuk del me atë do të publikojë foto në Facebook. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

### Digjet motori në hyrje të ndërtesës në bulevardin

#### "Asnom"

Një zjarr shpërtheu sot në hyrje të një ndërtese në lagjen "Novo Lisiçe" në Shkup. Ka marrë flakë një motor i cili ka qenë i parkuar në rrugën "Asnom" numër 64. Zjarri është shuar dhe është penguar përhapja e tij në banesat e ndërtesës.

Brigada territoriale zjarrfikëse e Qytetit të Shkupit ka intervenuar me tre automjete dhe gjashtë zjarrfikës, njoftoi MIA. Dëmi material ende nuk është konfirmuar. (O.Xh)

## "Trust" dhe "Transportuesi" shtyhen për më 30 dhe 31 janar

Shkup, 23 janar - Në Gjykatën Penale në Shkup dje u mbajt seancë për lëndën "Trust" të Prokurorisë Speciale Publike në të cilin u mor në pyetje eksperti Radomir Cvetanovski. Në marrjen në pyetje të mbrojtjes eksperti shpjegoi se si konfirmohet kapaciteti i thërmueses për qymyr. Eksperti tha se ka realizuar ekspertizë në karakteristikat teknike të thërmueses në vendin e ngjarjes dhe se në këtë makineri është inkuorporuar motori C13 me 440 kuaj fuqi

dhe kapacitet prej 350+ tonë në orë. Theksoi se është e rëndësishme ajo që në procedurën për marrje të koncesioneve për gërmim të lëndëve të para minerale përdoret njësia metër kub, ndërsa gjatë konfirmimit të zgjedhjes së pajisjes për gërmim dhe transport përdoret njësia në ton. Për shkak të caktimit të një tjetër gjykimi në të njëjtën sallë gjyqësore, gjykatësja Lidija Zimbova e ndërpreu marrjen në pyetje të ekspertit dhe caktoi seancë tjetër

më 30 janar në orën 10 i cili do të vazhdojë me marrjen në pyetje të ekspertit. I dyshuari i parë në lëndën "Trust" është biznesmeni Sead Kočan dhe tre persona juridik, midis të cilëve drejtuesit e firmave "Transmet", "Sileks" dhe VATO për pjesëmarrje në tender të Hidrocentraleve të Maqedonisë në vlerë prej 17 milionë eurosh me dokumente të falsifikuara. Në ndërkohë, edhe gjykimi për lëndën "Transportuesi" i PPS-së është shtyrë për më 31 janar.

Shtyrja, sipas gjykatësës të sapoemëruar në lëndën Dobrilla Kacarska, është për shkak të ankesës së parashtruar në Gjykatën e Apelit. Në lëndën "Transportuesi" janë të akuzuar ish-kryetari i komunës së Manastirit Vladimir Taleski dhe 20 persona të tjerë për keqpërdorim të pozitës zyrtare lidhur me organizimin e transportimit të nxënësve në Manastir, me ç'rast është bërë përvetësim i rreth 360.000 eurove.

Sipas kryetarëve të këtyre dy organizatave, Nuhi Dardhishta dhe Etem Xheladini, është krejt diçka tjetër të synosh reforma dhe krejt tjetër të gjuhë rrugën e duhur. Dhe, ajo që është më e rëndësishme, reforma apo model i ri i shkollimit duhet të përshtatet me kushtet reale të sistemit arsimor

## LASH-I I SHKUPIT DHE KUMANOVËS ME VËREJTJE



NUHI DARDHISHTA

**Më të privuar nga këto ndryshime do të jenë shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, për shkak se janë pikërisht këto shkolla të cilat vuajnë më së shumti mungesën e hapësirave. Reforma, të cilën e paralajmëron MASH-i për nxënësit e klasave të para mund të gjejë zbatim nëpër shkollat të vogla, për shembull të qyteteve si Dibra apo Kërçova, të cilat kanë numër të vogël nxënësish në klasë. Por, jo edhe në qytete si Shkupi, Tetova apo Kumanova, ku numri i nxënësve është i madh**

# 55 MINUTAT SHUMË LARG REALITETIT

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 23 janar - Dy organizatat më të vjetra dhe ende aktive arsimore në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, si LASH-i "Naim Frashëri" në Shkup ashtu edhe LASH-i "Naim Frashëri" në Kumanovë - nuk janë aspak optimiste për ndryshimet e paralajmëruara në arsimin fillor. Sipas kryetarëve të këtyre dy organizatave, Nuhi Dardhishta dhe Etem Xheladini, është krejt diçka tjetër të synosh reforma dhe krejt tjetër të gjuhë rrugën e duhur. Dhe, ajo që është më e rëndësishme, reforma apo model i ri i shkollimit duhet të përshtatet me kushtet reale të sistemit arsimor, vërejnë ato. "Koncepti që të zvogëlohet numri i lëndëve mësimore dhe që një orë mësimi të zgjatet në 55 minuta, me atë që 40 minuta të jetë kohë mësimore dhe 15 minuta të shfrytëzohen për pushim apo lojë nga ana e nxënësve, nuk është koncept i keq. Mirëpo në praktikë është një model, i cili nuk mund të zbatohet gjerësisht në shkollat tona", pohon Dardhishta, kryetari i Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri", në Shkup. Sipas tij, më të privuar nga këto ndryshime do të jenë shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, për shkak se janë pikërisht këto shkolla të cilat vuajnë më së shumti mungesën e hapësirave.

Reforma, të cilën e paralajmëron MASH-i për nxënësit e klasave të para, thotë se mund të gjejë zbatim nëpër shkolla të vogla, për shembull të qyteteve si Dibra apo Kërçova, të cilat kanë numër të vogël nxënësish në klasë. Por, jo edhe në qytete si Shkupi, Tetova apo Kumanova, ku numri i nxënësve është i madh. Aq më pak mund ta gjejë veten kjo reformë në shkollat e Çairit, shprehet Dardhishta, duke nënvizuar faktin se në

të gjitha shkollat fillore të kësaj komune është mbi mesataren numri i nxënësve në klasë në paralelet me mësimin në gjuhën shqipe.

"Në Perëndim, kushtet e shkollave janë krejt ndryshe, me klasa të gjera dhe pak nxënës në to. Që mësuesi të organizojë lojëra me nxënësit në klasë, përveç hapësirës konvencionale ku zhvillohet mësimi - klasa duhet të ketë të paktën edhe 20 metra katrorë hapësirë që u duhet plotësuese. Ndërsa shkollat tona e dimë të gjithë se si janë, nuk kanë hapësira të mjaftueshme as për 40 minutat e rëndomta të mësimi", shprehet ai. Këtë mendim ndan edhe Etem Xheladini, kryetari i LASH "Naim Frashërit" në Kumanovë. Shkollat tona nuk kanë as minimumin e kushteve që orët të zgjatet me nga 55 minuta dhe brenda kësaj kohe të organizohen lojëra apo mënyra tjera zbatimëse me karakter edukativo-arsimor, vëren ai. "Prandaj mendoj se reforma të cilën e paralajmëron MASH është shumë larg realitetit, janë larg mundësive për tu zbatuar, sidomos në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe", shprehet Xheladini. Një çështje tjetër e pa menduar mirë sa i takon ndryshimit të mundshëm në orës së mësimi në klasë të parë është edhe mos caktimi i kohës se

kur do të organizohet pushimi, respektivisht loja e nxënësve. "Nëse në një orë klasë pushimi do të jetë në mes të orës 55 minutëshe të mësimi, në tjetrën pas 30 minutave mësim dhe në një klasë tjetër pushimi do të jepet pas 40 minutave, do të jenë vetë klasat që do ta pengojnë njëra-tjetrën. Në shkollë s'do të merret vesh se kush është në mësim dhe kush në pushim. Dalja e nxënësve në pushim shoqërohet me zhurmë dhe kjo do të shkaktojë një kaos brenda shkollës", shpjegon Dardhishta. Ndërkaq Xheladini vë theksin edhe të çështja e orëve të mësimi. Sipas tij, vetëm emrat e lëndëve do të ndryshojnë, pasi me shkrimin e dy-tre lëndëve në një, brenda lëndës së re do të gjenden po ata njësi mësimore që ishin në lëndët e vjetra. "Pra, po punohet vetëm për t'i treguar opinionit se ja po mbajmë premtimet tona politike për reforma në arsim. Kështu është shkatërruar arsimi dhe është në gjenden të cilën e kemi sot", shprehet ai.

Dardhishta dhe Xheladini, dy kryetarët e LASH "Naim Frashërit" në Shkup dhe Kumanovë, konsiderojnë se gjeneza e të gjitha problemeve qëndron në mos konsultimin e MASH-it me profesionistë dhe ekspertë të fushës. "MASH-i ka nis të bëjë reforma, duke mos

dëgjuar zërin e ekspertëve. Ka formuar grupe me anëtarë të Plenumit të profesorëve ndërsa nuk ka ftuar LASH-in që vepron prej gati tre dekada", shprehet Dardhishta. Sipas tij, edhe ashtu siç janë formuar grupet e punës janë bërë "sa për sy e faqe", ashti sikurse edhe takimet me shoqërinë civile. Askund të botë, reformat nuk ideohen dhe nuk dizajnohen me një-dy apo tre takim para se ndryshimet të paralajmërohen nga ministria. Për to angazhohen ekspertë dhe specialist të fushës. "Për shkak të qasjeve të tilla, të gjitha reformat që janë bërë në arsim kanë dështuar dhe e kanë sjell arsimin në gjendje të mjerueshme", shprehet Xheladini nga LASH-i i Kumanovës. Edhe në rastin konkret, sipas tij dëshmohej se njerëzit që ndërmarrin iniciativë për reforma si këta që paralajmërohen në arsimin fillor, nuk janë të reformuar sa duhet për veten tyre.

## TË PAGUHEN PAGAT E TË PUNËSUARVE NË KOPSHTË DHE SHKOLLA

**Sindikata e Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Republikës së Maqedonisë (SASHK) kërkon që urgjentisht të gjendet zgjidhje që të paguhet paga për dhjetorin për të punësuarit në kopshte, shkollat fillore dhe të mesme në Çair, Tetovë, Tearcë dhe Gostivar, ku, siç kumton, për shkaqe politike, nuk janë miratuar buxhetet komunale. Nëse në afatin më të shkurtër të mundshëm nuk paguhet pagat, prej SASHK paralajmërojnë masa më radikale prej organizatave të tyre sindikaliste për realizimin të drejtës ligjore për pagesën e pagave. "Për arsye të karakterit politik, këshillat komunal në**

**Çair, Tetovë, Tearcë dhe Gostivar akoma nuk e kanë përfunduar procedurën ligjore për miratimin e Buxhetit për vitin 2018, me çka bëhet bllokim total financiar dhe pamundësohet që mijëra të punësuar prej veprimtarive që i mbulon SASHK të mos mund të marrin paga", thekson në kumtesë SASHK. Tregon për seriozitetin e kësaj situatë dhe kërkon përgjegjësi maksimale prej të gjithë faktorëve dhe siç thekson, kreatorëve të këtij problemi, me qëllim që sa më shpejtë të tejkalohet kjo situatë dhe të mund të paguhet pagat në afatin më të shkurtër të mundshëm.**

## 1739 të prekur nga gripi, dy raste të reja të morbileve

Shkup, 23 janar - Komisioni për sëmundje infektuese në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë konstatoi se gripi akoma është me aktivitet të ulët. Për momentin janë regjistruar 1.739 raste të të prekurve nga gripi dhe pritet rritje e aktivizimit në periudhën e ardhshme. Nga Ministria kumtuan se Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor ka dërguar vendime në shkollat e mesme dhe fillore për ndërmarrjen e masave për pastrimin dhe dezinfektimin e hapësirave shkollore, sigurimin e mjeteve për higjienë personale (sapun të lëngshëm) si dhe ndjekjen e rregullt të mungesës së fëmijëve nga mësimi. Komisioni për sëmundje infektuese e ka shqyrtuar edhe mundësinë me morbilet (fruthin). Janë paraqitur dy raste të reja të morbileve nga Instituti për Shëndet Publik. Bëhet fjalë për një fëmijë gjashtëmujsh, i cili për shkak të moshës akoma nuk është vaksinuar (nuk iu nënshtrua vaksinës) dhe është në gjendje të mirë të përgjithshme. Rasti i dytë është një burrë i moshës 40-vjeçare (i vaksinuar me një dozë vaksine), i cili është kontrolluar vetëm në ambulancë dhe është lëshuar për mjekim shtëpiak. Për të dy rastet ekzistojnë të dhëna për lidhje epidemiologjike, si dhe të dhëna për kontakt me një të sëmurë për morbile. Gjithashtu, janë zbatuar ndjekje epidemiologjike të më të afërmve dhe kontakteve për nevojën eventuale prej vaksinimit me vaksinën MRP, qëndron në kumtesën e Ministrisë së Shëndetësisë.

## Paga mesatare 23.196 denarë

Shkup, 23 janar - Neto paga mesatare mujore e paguar për të punësuar, në nëntor të vitit të kaluar ka arritur 23.196 denarë, dhe është më e lartë për 3.6 për qind krahasuar me nëntorin e vitit 2016, publikoi sot Enti Shtetëror i Statistikës. Rritja e tillë është falë, para se gjithash, rritjes së neto pagës së rritur mesatare mujore të paguar për të punësuar në sektorët: industrinë e përpunimit për 8.9, objektet për akomodim dhe veprimtari servisi me ushqim për 8.7 për qind dhe bujqësi, pylltari dhe peshkari për 7.6 për qind. Ulje të neto pagës mesatare mujore të paguar për të punësuar, në nëntor në krahasim me tetorin e vitit 2017, statistika ka regjistruar në sektorët: art, argëtim dhe rekreacion për 15.8 për qind, transport dhe deponim për 5.9 për qind dhe veprimtari të profesionale, shkencore dhe teknike për 4.3 për qind. Bruto paga mesatare mujore e paguar për të punësuar në nëntor të vitit 2017 ka arritur 34.079 denarë. Në nëntor të vitit të kaluar 1.1 për qind nga të punësuarit në Republikën e Maqedonisë nuk kanë marrë paga.

Modeli i transferimit të kompetencave është një prej arsyeve, po aq sa edhe kapacitetet e limituara financiare të komunave për të mbështetur si duhet funksionimin e tyre. Në disa prej qendrave në komunat shqiptare, të cilat funksionojnë në kushte jo të volitshme, pohojnë se menaxhimi nga vetëqeverisja lokale nuk do të kishte efekte pozitive, nëse do të lihej tërësisht në kompetenca të komunave

Koha

Evis HALILI

Shkup, 23 janar - Transformimi i qendrave të kulturës nga institucione në varësi të pushtetit qendror në atë lokal, një prej masave të paralajmëruara në kuadër të procesit të decentralizimit institucional, është pritur me rezerva nga vetë drejtuesit e tyre. Modeli i transferimit të kompetencave është një prej arsyeve, po aq sa edhe kapacitetet e limituara financiare të komunave për të mbështetur si duhet funksionimin e tyre. Në disa prej qendrave në komunat shqiptare, të cilat funksionojnë në kushte jo të volitshme, pohojnë se menaxhimi nuk do të kishte efekte pozitive, nëse do të lihej tërësisht në kompetenca të komunave.

Në versionin jozyrtar të Strategjisë për kulturën, procesi i decentralizimit institucional është një prej hapave kryesore për vetë decentralizimin e kulturës. Një prej masave të domosdoshme reformuese është përcaktimi i kritereve të qarta për përcaktimin e rrjetit të institucioneve publike, përkatesi-

## QENDRAT E KULTURËS DREJT TRANSFORMIMIT

# FRIKË NGA DECENTRALIZIMI



sht revidimin e rrjetit aktual të institucioneve nacionale. Disa prej tyre, thuhet në Strategji, do të transformohen sipas modeleve të ndryshme - do të kalojnë në nivel lokal, një pjesë do të rregullohen sipas principit të partneritetit publik-privat, të tjerat do të shndërrohen në qendra kulture të komunitetit, por do të ketë edhe institucione që do t'i jepen për t'u menaxhuar organizatave nga sektori i pavarur.

Nëse qendrat e kulturës do të kalonin në kompetenca të komunës, ky do të ishte një lloj kapitullimi i paevitueshëm, thotë drejtori i Qendrës së Kulturës në Gostivar, Luan Zenku. Si shembull për decentralizimin e keq, ai jep rastin e qendrës në Vrapçishtit (Negotinë), e cila pas shndërrimit të qendër lokale reduktoi në minimum funksionimin.

"Procesi i decentralizimit do të jetë problem i vërtetë për ekzistencën tonë. Nëse i referohemi shpenzimeve tona që janë diku 300 mijë euro, ndërsa të hyrat vjetore nuk shkojnë më shumë se 15 mijë euro, nga rentimi i hapësirave, anëtarësia e bibliotekës, e të tjera. Dhe besoj se kostoja financiare vjetore do të krijonte një pus në buxhetin e komunës, që realisht nuk mund të

themi se ka si prioritet kulturën, pasi ka prioritetet e tjera. Pra kalimi në nivel lokal do të sillte paralizimin e aktiviteteve, ndërsa kështu duke funksionuar si institucion nacional ajo çfarë përfitojmë nga Ministria e Kulturës është e mjaftueshme për të menaxhuar me aktivitetet e kulturës", thotë Zenku.

Nëse qendrat e kulturës do t'i kalonin komunave në këtë gjendje në të cilën janë, do të shndërroheshin në një ngarkesë të papërbalueshme, thotë drejtori i Qendrës së Kulturës në Tetovë, Haki Fazliu. "Vetë procesi i decentralizimit është një avantazh, pasi situatat janë të prekshme dhe linku i komunikimit është i drejtpërdrejtë mes qendrës dhe komunës. Por nëse të themi ky proces do të kryhet pa përfunduar rikonstruktimin e plotë të vetë objektit, siç është rasti me qendrën tonë që ka një sërë problemesh, krijimi i kushteve optimale të funksionimit ne nuk do të ishim asgjë më shumë përveç se një ngarkesë për komunën dhe jo institucion profitabil dhe në shërbim të kulturës e qytetarëve", thotë Fazliu. Pushteti lokal është më pranë popullit dhe i njeh më mirë nevojat e komunitetit, por gjithçka do varet nga modeli që do të zbatohet për

decentralizimin, thotë një tjetër drejtor, Artim Spahiu, i Qendrës së Kulturës së komunës së Dibërës.

"Nëse decentralizimi do të ndodhë ashtu siç edhe flitet, që edhe financat do të jenë në kompetenca të komunës, atëherë ky proces do të jetë i vështirë për një pjesë prej nesh. Sidomos për ne këtu në Dibër, në bazë të të hyrave që ka kjo komunë, vetë potencialit financiar që disponon, do të ishte vështirë kalimi në vetëqeverisje lokale. Në qoftë se do të ishte komplet e menaxhuar dhe e financuar nga komuna qendra do të haste në vështirësi dhe nuk do të funksiononte ashtu si funksionon tani", thotë drejtori Spahiu. Vite më parë institucionet publike të kulturës u ndanë në nacionale dhe lokale, duke rritur artificialisht numrin e institucioneve nacionale dhe jo sipas mundësive dhe nevojave reale. Përmes buxhetit të Ministrisë së Kulturës, financohen 112 institucione, 63 prej të cilave kanë statusin nacional (me mbi 2.700 punonjës), ndërsa të tjerat janë institucione lokale. Këto shifra, në analizën më të fundit të Ministrisë së Kulturës, flasin për shpërndarjen e zhdrejta institucionale dhe kadrovike në kulturë.

## Shtyhen ndryshimet e Ligjit për referendum

Shkup, 23 janar - Ministria e Drejtësisë në kumtesën e re të korrigjuar informon se janë shtyrë ndryshimet e propozuara të Ligjit për referendum dhe format e tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, duke potencuar se me to nuk ndryshohet thelbi i ligjit, por bëhet fjalë për harmonizimin e termave me ligjet e tjera. Paraprakisht, pas informacioneve të një pjese të mediave shpallja e ndryshimeve të propozuara në Regjistrin e Vetëm Kombëtar të Rregulloreve (ENER) Ministria e Drejtësisë kumtoi se ato bëhen për shkak të harmonizimit me Kodin Zgjedhor dhe lihen ose tejkalohen disa zgjidhje të vjetruara, për arsye se Ligji për referendum dhe format e tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve është miratuar në shtator të vitit 2005, ndërsa Kodi Zgjedhor në mars të vitit 2006. "Me ndryshimet e propozuara të nenit 1, nenit 2, nenit 3 dhe nenit 4 të Ligjit për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve po bëhet harmonizimi me Kodin Zgjedhor. Kodi Zgjedhor është shpallur më 31 mars të vitit 2006 dhe ka hyrë në fuqi që ditën kur është shpallur në Gazetën Zyrtare. Me ditën e publikimit të Kodit Zgjedhor, ndërkaq, ndaluan të vlejnjë Ligji për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Maqedonisë, Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Ligji për zgjedhjet lokale, Ligji për listën zgjedhore, Ligji për vendvotimet dhe Ligji për njësitë zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë", citohet në kumtesë. Shtohet se me ndryshimet e propozuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, bëhet harmonizimi i ligjit të propozuar me Ligjin për Gjykatat. "Në Ligjin për gjykatat i cili është shpallur në maj të viti 2006, ndërsa ku me nenin 22, përveç gjykatave ekzistuese, u themelua edhe Gjykata Administrative. Neni 34 i Ligjit për gjykatat rregullon kompetencat e Gjykatës Administrative. Njëherit, me Ligjin për gjykatat kompetenca për zgjidhjen e kontesteve administrative nga Gjykata Supreme kalon në Gjykatën Administrative", kumton Ministria e Drejtësisë, duke theksuar se me ndryshimet e propozuara në Ligjin për referendum dhe formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve kryhet rregullimi i çështjeve të cilat janë me rëndësi për zbatim praktik dhe përshtatje teknike të tekstit të ligjit. Propozimi i ligjit për ndryshimin e Ligjit për referendum dhe formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve ishte vendosur në ENER, por nga pasdita ai është tërhequr.

## QEVERIA MIRATOI FONDET PËR KËTË VIT

# MBI 16 MILIARDË DENARË PËR RRUGËT

Shkup, 23 janar - Investime prej 16.748.600.000 denarëve janë parashikuar me Programin vjetor për ndërtim, rikonstruksion, rehabilitim dhe mirëmbajtje të rrugëve shtetërore për vitin 2018 të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, që u miratua në seancën e fundit qeveritare. "Qeveria në mënyrë intensive do të vazhdojë me ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës rrugore me qëllim që të stimulohet rritja ekonomike dhe zhvillimi i vendit, kumtoi Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Në program, informoi janë përfshirë ndërtimin dhe rikonstruksionin i rrugëve nga mjete vetanake të NP për rrugë shtetërore, si dhe vazhdimi i projekteve vijuese për ndërtim të autostradave

Kërçovë-Ohër dhe Milladinovc-Shtip, me hua nga banka Eksim, si dhe projekte të rrugëve me mjete të siguruar nga Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Nga fondet vetanake të NP për rrugë shtetërore, paralajmërohen punët ndërtimore, ndër të tjera, aksi rrugor Opajë-Bellanovc-Stançiq, vazhdim dhe rehabilitim i aksit Negotinë-Demir Kapi, ndërtim i rrugës rajonale Krahu 1 (Faza 2) afër fabrikës Vevçanka - Shtëpia e Shëndetit Vevčan, si dhe rehabilitimi i aksit Ohër tek pompa e benzinës Biljanini Izvori - Konjsko, Saraj-Grupçin, Petrovec - Milladinovc dhe Kadino - Hipodrom, Manastir-Novaci, Petrovec - Katllanovë, Berovë-Strumicë, .... Me këto para planifikohet ndërtimi i pikave

pagesore në autostrada (para Kadrifakovë- Arbinovë), sanim dhe ndërtim i urave, sanim i rrëshqitjet e tokës, ndriçim i më shumë unazave dhe urave, instalimi i shenjave të komunikacionit dhe pajisjeve rrugore. Projekti për vlerësim i sigurisë në rrugë - IRAP dhe ndërtimi i seksionit rrugës ekspres Rankovc - Kriva Pallankë dhe rrugëve Strumicë - Novo Sellë, Kavadar - Rosoman, Kumanovë - Sveti Nikole, Tetovë - Kodra e Diellit, Dellçevë - Pehçevë ... janë pjesë e aktiviteteve të planifikuara me hua nga Banka Botërore. Në projektet që do të realizohen me të holla nga BERZH janë përfshirë zgjerimi i korsisë së majtë dhe rindërtimi i dy korsive në autostradën Katllanovë-Petrovec, rindërtimi i auto-

stradave Milladinovc- Petrovec, Hipodrom - Petrovec dhe Milladinovc- Hipodrom, si dhe i rrugëve Probishtip-Krupishte, Shtip-Radovish, Kriva Pallankë, Rankovc, Shkup-Bllacë Podmoljn-Qafë Thanë-Strugë, Kumanovë-Sveti Nikole, Manastir Mexhitli... Programi vjetor përfshin edhe mirëmbajtje investuese të rrugëve që do të realizohet përmes një marrëveshjeje me NP Rrugët e Maqedonisë, si dhe përpunimi i dokumentacionit dhe mbikëqyrjes mbi punët ndërtimore të rrugëve shtetërore (përpunim i fizibilitetit studimeve, projekteve infrastrukturore, studime për mjedisin jetësor, projekte themelore, si dhe mbikëqyrje e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.

Mes tjerash, që nga fillimet e veta në vitin 1993, USAID ka përkrahur sundimin e të drejtës në Maqedoni. Fillimisht, përkrahja ishte drejtuar kah ndërtimi i kapaciteteve të shoqatave profesionale të juristëve (Shoqata e gjykatësve, Oda e avokatëve dhe Shoqata e prokurorëve publikë), sigurimi i edukimit klinik të studentëve të drejtësisë, dhe përkrahja e edukimit të vazhdueshëm i gjykatësve

*Shkup, 23 janar* - Këtë vit, USAID-i shënon 25 vjetorin e aktiviteteve në Maqedoni. Që nga viti 1993, populli amerikan ka investuar më shumë se 610 milionë dollarë amerikanë në Maqedoni përmes USAID-it, e cila punon me qytetarët për të krijuar vende pune, për të forcuar institucionet dhe praktikën demokratike, për të përmirësuar arsimin e integruar dhe për t'i përgatitur nxënësit për tregun modern të punës. Mes tjerash, që nga fillimet e veta në vitin 1993, USAID ka përkrahur sundimin e të drejtës në Maqedoni. Fillimisht, përkrahja ishte drejtuar kah ndërtimi i kapaciteteve të shoqatave profesionale të juristëve (Shoqata e gjykatësve, Oda e avokatëve dhe Shoqata e prokurorëve publikë), sigurimi i edukimit klinik të studentëve të drejtësisë, dhe përkrahja e edukimit të vazhdueshëm i gjykatësve. Në periudhën mes viteve 2002 dhe 2015, USAID bashkëpunoi me gjyqësinë dhe me Ministrinë e Drejtësisë në krijimin e rregullativës ligjore për reformimin e sistemit gjyqësor, si dhe në rritjen e efikasitetit të gjykatësve në zgjidhjen e lëndëve, në automatizimin e procedurave gjyqësore dhe në profesionalizimin e personelit gjyqësor. Në

## USAID-I SHËNON 25 VITE PUNË

USAID 25 ГОДИНИ

ЗА ТОА СЕ ВИСТИНСКИТЕ ПРИЈАТЕЛИ!



# PRIORITET, TË DREJTAT E NJERIUT

disa vitet e fundit, fokusi i përkrahjes së USAID në fushën e sundimit të së drejtës u zhvendos në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut, në projektet e USAID-it janë standarde që mundësojnë që çdo njeri të jetojë me dinjitet, i lirë dhe i barabartë me të tjerët. Secili individ i ka këto të drejta të patjetërsueshme qysh në lindje. Të drejtat e njeriut bazohen mbi vlera si dinjiteti, drejtësia, barazia, respekti dhe pavarësia. Ato nuk janë vetëm koncepte abstrakte, por të drejta të definuara dhe të mbrojtura me deklarata dhe konventa ndërkombëtare, si edhe me legjislacionin nacional në pjesën më të madhe të shteteve në botë. Në Maqedoni, sundimi i të drejtës dhe të drejtat e njeriut janë vlera themelore të rendit kushtetues. Përmes disa projekteve, USAID u inkuadrua edhe në mbrojtjen dhe promovimin

e të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë në Maqedoni dhe e mbështeti implementimin e Strategjisë nacionale për barazi dhe jodiskriminim.

Në periudhën prej tetorit të vitit 2014 deri në shtator të vitit 2017, Projekti për mbrojtjen juridike të grave punoi në mbrojtjen e grave viktime të çdo lloji të dhunës gjinore nëpërmjet ndjekjes së lëndëve gjyqësore, në përforcimin e kapaciteteve të gjykatësve, propozimin e ndryshimeve ligjore, si edhe trajnimin e organizatave civile. Nëpërmjet këtij projekti u vëzhguan 344 procedura gjyqësore për raste për dhunë mbi gra të udhëhequra në 10 gjykata themelore, u trajnuan 20 gjykatës për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të Konventës për eliminimin e diskriminimit të grave dhe 13 organizata civile përfituan njohuri për shfrytëzimin e

mekanismave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të grave. U sigurua ndihmë juridike falas për 847 gra, 239 gra morën mbështetje psiko-sociale dhe 5 gra viktime të dhunës u mbrojtën në procedura gjyqësore. Projekti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili zbatohet prej në shtator të vitit 2014 deri në fund të vitit 2017, kishte për qëllim të kontribuojë në përparimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të juristëve të rinj, përfaqësimin strategjik të lëndëve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut, dhe përmes përforcimit të rolit të organizatave qytetare në këtë fushë. Nëpërmjet këtij projekti, 42 avokatë u specializuan për përfaqësimin e lëndëve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut para gjykatave vendore dhe para Gjykatës Evropiane për të drejtat e

njeriut; 392 juristë të rinj fituan njohuri dhe aftësi praktike në fushën e të drejtave të njeriut dhe u njoftuan me mekanizmin e mbrojtjes së tyre të cilin do të mund t'i zbatojnë si gjykatës, prokurorë ose avokatë të ardhshëm; 355 qytetarë morrën ndihmë juridike falas; ndërsa 15 organizata qytetare u trajnuan si të angazhohen për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve nga ana e institucioneve shtetërore. Me përfaqësimin e 62 lëndëve të shkeljes së të drejtave dhe lirive, Projekti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut promovonte ndryshim në sjelljen dhe qëndrimet e institucioneve, në praktikën gjyqësore dhe rregullativën ligjore. Ndër sukseset më të dalluara të këtij projekti ishte abrogimi i dy akteve nënligjore të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, zbatimi retroaktiv i të cilëve u morri të drejtën për ndihmë sociale më tepër se 1300 shfrytëzuesve. Me sukses përfundoi edhe përfaqësimi i lëndëve të pjesëtarëve të bashkësisë Rome, të cilëve u ishte privuar e drejta e lëvizjes dhe u ishte pamundësuar dalja jashtë shtetit për shkak të dyshimit se do e keqpërdornin regjimin pa viza dhe do të kërkonin azil në vendet e Zonës së Shengenit.

## DY PROJEKTET AKTIVE

**Për momentin, USAID ka dy projekte aktive në fushën e të drejtave të njeriut. I pari ka për qëllim të reduktojë diskriminimin e pjesëtarëve të bashkësisë LGBTI në Maqedoni dhe të inkurajojë inkuadrim të tyre të barabartë në shoqëri. Me këtë projekt, për herë të parë në Maqedoni u hap shtëpi sigurie, e cila ofron strehim dhe mbështetje psiko-sociale për**

**personat e ndjeshëm të komunitetit LGBTI që janë të përjashtuar dhe të ekspozuar në dhunë në familjet dhe bashkësitë e veta. Projekti i dytë mbështet ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe organizatave qytetare për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve, në përputhje me standardet e miratuara ndërkombëtare.**

## NUK KA NUMËR TË SAKTË SA PERSONA FIZIK JANË OBLIGUES TË TVSH-SË

Sipas ligjit, gjobat për personat fizik të cilët nuk do të regjistrohen si obligues të TVSH-së arrijnë prej 250 deri në 375 euro. Tani për tani nga Ministria e Financave nuk ka informacione nëse do të ndryshohet pragu dhe nëse ai do të rritet sërish në dy milionë siç ishte para vitit 2015

*Shkup, 23 janar* - Pas përfundimit të afatit për regjistrimin e qëllimeve të TVSH-së për personat fizik të cilët kanë realizuar të ardhura mbi një milionë denarë në Drejtorinë e

Ardhurave Publike, DAP-i ka afat prej 15-të ditëve të përpiltojë vendim lidhur me fletëparaqitjen e dorëzuar për regjistrim. Tani për tani në DAP nuk kanë numër sa persona fizik kanë për obligim ta bëjnë këtë. Gjendjen mund ta shqyrtojnë pasi do të përfundojnë afatet për parashtrimin e raporteve vjetore nga paguesit e të ardhurave dhe përpunimit të fletëparaqitjeve vjetore tatimore për të ardhura të realizuara shtesë. Të gjithë obliguesit tatimor - persona fizik të cilët ushtrojnë veprimtari tatimore ekonomike për qëllimet e TVSH-së, ndërsa në vitin paraprak kalendarik (2017) kanë realizuar qarkullim të përgjithshëm prej mbi 1.000.000,00 denarë kanë për obligim deri te DAP-i të parashtrorjnë Fletëparaqitje për regjistrim për qëllimet e TVSH-së më së voni deri më 15 janar të vitit 2018. "Në

pajtim me nenin 51-a të Ligjit për TVSH, organi kompetent tatimor për Fletëparaqitjen për regjistrimin e tatimit të vlerës së shtuar sjell vendim në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të parashtrësës. Në mënyrë shtesë që të mund organi për të ardhura publike të konfirmojë sa tatimpagues kanë realizuar qarkullim mbi 1.000.000,00 denarë, duhet të përpunohen të dhënat nga Raportet vjetore nga paguesit e të ardhurave të cilat i dorëzojnë të njëjtit deri te DAP-i më së voni deri më 31 janar të vitit 2018, si dhe nga përpunimi i fletëparaqitjeve vjetore tatimore për konfirmimin e tatimit vjetor të të ardhurave për vitin 2017, afati i së cilës për parashtrim është bashkë me 15 marsin e vitit 2018. Pas vendosjes së tërësishme dhe përpunimit të parashtrësve të dorëzuara Drejtoria e të Ardhurave Publike do t'i mbledh të dhënat dhe do të mund t'i shqyrtojë gjendjet", thonë nga Drejtoria e të Ardhurave Publike. Në këtë kategori hyjnë të ardhurat e realizuara në bazë të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, siç janë veprimtari të ekspertëve dhe udhëheqësve falimentues, të ardhura nga veprimtaria bujqësore, të ardhura të realizuara në bazë të kontratës në vepër, të ardhura të realizuara nga dhënia me qira e hapësirave afariste, të ardhura të realizuara nga marrëveshjet autoriale dhe të drejtat nga prona industriale, të ardhura në bazë të anëtarësimit në borde drejtuese dhe të ngjashme. Në Maqedoni, sipas Ligjit për TVSH, obligues tatimor është personi i cili vazhdimisht apo kohë pas kohe në mënyrë të pavarur ushtron veprimtari ekonomike pavarësisht nga qëllimet dhe rezultata-

tet nga kjo veprimtari. Obligimi i tillë ekziston me miratimin e Ligjit për TVSH në vitin 1999. Deri më 1 janar të vitit 2015 pragu ishte më i lartë dhe arrinte dy milionë denarë, ndërsa prej 1 janarit të vitit 2015 me ndryshimin e Ligjit është ulur në një milionë denarë. Ky është viti i dytë me radhë në të cilin duhet personat fizik të parashtrorjnë fletëparaqitje deri te Drejtoria e të Ardhurave Publike të cilët kanë realizuar një milion denarë, gjegjësisht për vitin 2016 edhe këtë vit për të ardhura të realizuara në vitin 2017. Sipas ligjit, gjobat për personat fizik të cilët nuk do të regjistrohen si obligues të TVSH-së arrijnë prej 250 deri në 375 euro. Tani për tani nga Ministria e Financave nuk ka informacione nëse do të ndryshohet pragu dhe nëse ai do të rritet sërish në dy milionë siç ishte para vitit 2015.



Ramadan Tahiri, kryetar i Këshillit të Xhamisë së Rinisë thekson se ky është tentimi i tretë për vjedhje, por hajnat kanë dështuar, sepse është aktivizuar menjëherë alarmi

## TETOVË, TRE XHAMI VIDHEN PËR DY DITË



# HAJNAT E XHAMIVE

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 janar - Kohëve të fundit sërisht në skenë kanë dalë hajnat nëpër objektet fetare. Pas vjedhjes në Xhaminë në Reçicë të vogël, cak i hajnave kanë qenë Xhamia e Pashës në Tetovës dhe xhamia e "Rinisë" në rrugën 176 në lagjen e Vardarskës. Nga Këshilli i kësaj xhamie theksuan se hajnat kanë arritur të hyjnë brenda, por jo edhe të marrin diçka. Personat përgjegjës në këtë xhami në Tetovë thonë se disponojmë me pamjet nga akti i hyrjes së hajnit në xhami përmes kamerave të sigurisë. Ramadan Tahiri, kryetar i Këshillit të xhamisë thekson se ky është tentimi i tretë për vjedhje, por hajnat kanë dështuar, sepse është aktivizuar menjëherë alarmi. "Ky është tentimi i tretë apo i katërt për të vjedhur në këtë xhami, por fatmirësisht për shkak të mbulimit të mirë me kamera dhe alarm, në dy herët i kemi kapur vet hajnat më pas i kemi dorëzuar në polici. Kësaj radhe nuk arritëm t'i kapim, sepse ai është larguar me shpejtësi, kështu që dëme nuk kemi, por vetëm që është bërë thyerja e dritares dhe ka mbetur edhe një shufër prej çeliku e cila është marrë nga ana e policisë për hetim", tha Tahiri. Ai vlerëson se

vjedhja në objekte fetare është turp. Por ka edhe një porosi për hajnat, ngase i tërë objekti kontrollohet nga kamerat e sigurisë në çdo kohë. "Kjo është një dukuri shumë e shëmtuar, sepse vjedhjet në objekte fetare është marri që nuk i takon një njeriu që logjikon për të hyrë në objekt fetar - kishë apo xhami, sepse mjetet janë për mirëmbajtje dhe nevoja të ultit. Unë kam një porosi për ata që tentojnë të vjedhin në xhami, sidomos në xhaminë tonë - mos të tentojnë, sepse pos që kemi kamera në objekt, ato kamera i përcjellim edhe nga shtëpitë tona dhe është shumë vështirë të vjedhin dhe vetëm mund të turpërohen ngase e dimë se kush janë", theksoi ai.

Megjithatë, edhe pse ekzistojnë kamerat e sigurisë - hajnat nuk janë kapur nga ana e policisë, pohojnë në xhaminë e Rinisë. "Organet e rendit i kanë listat e personave që tentojnë të vjedhin, megjithatë nuk shohim ndonjë aksion për kapjen e tyre. Ne disa herë i kemi kapur dhe i kemi dorëzuar, por ka raste kur nuk është kapur, por vetëm fytyra nuk është dalluar në kamerë, por pjesët tjera dallohen mirë dhe këto janë argument që policia të bëjë identifikimin, por si duket mos marrja e masave i ka trimëruar hajnat të kryejnë këto vepra të shëmtuara", tha ai. Përndryshe, krahas xhamisë së Rinisë, të dielën në periudhën kohore nga ora 19.40 minuta deri

në orën 4.00 pas mesnate në xhaminë e Pashës në Tetovë një person i panjohur ka kryer një vjedhje. Personi në fjalë pasi me forcë ka hapur derën hyrëse të xhamisë, ka hyrë brenda dhe nga një kuti, ku besimtarët kanë grumbulluar rreth 5000 denarë për qëllime humanitare dhe bamirësie. Hetim në vendin e ngjarjes ka kryer një ekip nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për gjetjen e kryerësit të kësaj vjedhjeje si dhe zbardhjen e plotë të rastit. Vetëm brenda tre ditëve, në Tetovë hajnat kanë vjedhur dhe tentuar të vjedhin në tre xhami, dukuri kjo që është dënuar edhe nga Myftinisi së Tetovës.

## Mbledhje komemorative për Nexhadin Ramadanin

Tetovë, 23 janar - Me rastin e ndarjes nga jeta të mësuesit Nexhadin Ramadanin, në shkollën fillore "Liria" në Tetovë është mbajtur një mbledhje komemorative në kujtim të angazhimit, kontributit të tij shumëvjeçarë në arsimimin e shumë gjeneratave pranë kësaj shkolle. Në këtë mbledhje komemorative morën pjesë familjarë, kolegë, miq, bashkëpunëtor të cilët mes dhimbjes dhe lotëve kujtuan jetën dhe veprën e pavdekshme të arsimtarit tanimë të ndjerë Nexhadin Ramadanit. Vepra dhe kontributi i tij për ngritjen e arsimit është vlerësuar lartë nga miqtë dhe kolegët e tij të arsimit. Në emër të familjes, në këtë mbledhje komemorative foli djali arsimtarit Nexhadin, Haqim Ramadanin i cili përveç falënderimeve që shprehi për organizimin e kësaj mbledhjeje komemorative ka vlerësuar shpirtin e mirë dhe fisnik të babait të tij duke thënë se ai edhe në situatë të rënda ka ditur që të krijoj pozitivet dhe të jetë gjithmonë i buzëqeshur. Përndryshe, mësuesi Nexhatin Ramadanin ndërroi jetë dje pas një sëmundje të rëndë, vdekja e tij ishte e papritur, e hershme andaj edhe dhembja është shumë e madhe për familjarët, miqtë dhe kolegët, por padyshim se kujtimi për jetën dhe veprën e tij të pavdekshme do të jetë i përjetshëm.

Për çdo prodhim apo shërbim të shfrytëzuar, që qytetarët paguajnë tatim prej 18 për qind përmes llogarive fiskale, shteti në fund të këtij viti do t'u kthejë në llogari të tyre 15 për qind nga TVSH. Sipas llogarive të para kjo do të thotë se në vit në një familje do të hyjnë diku rreth 30,000 denarë apo 500 euro para plotësues përveç rrogave mujore

## STIMULIMI FISKALI QYTETARËVE

# A DO TË PAGUHEN 500 EURO NË FUND TË VITIT?

zgjedhore. Pas formimit të qeverisë kjo masë duhet të miratohej nga kabineti i kryeministrit Zoran Zaev dhe se ky ligj së pari do të fillojë si pilot projekt nga muaji janar i këtij viti në disa komuna e më pas do të zgjerohet në gjithë vendin nga fillimi i vitit 2019. "Si masë shumë e rëndësishme që do ta zbatojmë nga janari i vitit 2018 dhe Parlamenti duhet ta miraton është ligji për kthimin e 15 për qind të tatimit mbi vlerën e shtuar qytetarëve. Të gjithë qytetarët për çdo ditë paguajnë gjithçka që do të thotë jetë. Për gjithçka paguajnë tatimin e vlerës së shtuar. Nëse brenda një dite qytetari ka shpenzuar 1000 denarë, ai ka paguar 180 denarë TVSH. Ne si qeveri propozojmë 15 për qind nga vlera e TVSH-së paguar në faturat e rrymës, ujit, harxhimet për blerje të ushqimit, rrobave, apo për gjithçka që ka pa-

guar qytetari brenda një viti shteti do të kthejë 500 euro çdo familje", kështu pat deklaruar kryeministri Zaev menjëherë pas fitoi mandatin për të formuar qeveri.

Mirëpo tani kur janari është kah fundi, Qeveria dhe Ministria e Financave nuk japin informata nëse ky ligj është miratuar dhe ka hyrë në fuqi dhe se cilat komuna në fund të këtij viti do t'u kthejnë qytetarëve 500 euro të tatimit të vlerës së shtuar. Para përfundimit të vitit 2017, kryeministri Zaev dhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev realizuan një takim me kompaninë e huaj ZTE e cila ua prezantoi përfaqësuesve të Qeverisë së Maqedonisë konceptin e përpunimit të kartelës elektronike e cila do të përmbajë të gjitha të dhënat e qytetarit dhe në këtë kartelë elektronike të posaçme do të regjistrohen

paratë e tatimit të kthyer nga TVSH. "Për çdo prodhim apo shërbim të shfrytëzuar, që qytetarët paguajnë tatim prej 18 për qind përmes llogarive fiskale, 15 për qind nga TVSH-ja shteti në fund të këtij viti do t'u kthejë në në llogari të tyre. Sipas llogarive të para kjo do të thotë se në vit në një familje do të hyjnë diku rreth 30.000 denarë. Sipas këtij ligji, për çdo prodhim apo shërbim të shfrytëzuar për të cilin shtetit i paguajnë qytetarët tatim prej 15 për qind përmes llogarive fiskale, do t'u kthehen qytetarëve në llogari të qytetarëve që do të thotë se në fund të vitit 2018 në një familje do të hyjnë diku rreth 30.000 denarë. Me këtë masë qeveria planifikon të sigurojë për qytetarët të hyra plotësuese, në nivel vjetor përveç rrogës edhe 30.000 denarë për çdo familje", pati deklaruar kryeministri Zaev pas takimit

me përfaqësuesit e kompanisë ZTE.

Edhe përkundër tentimit që të mësojmë më shumë se a ka filluar të zbatohet ky ligj nga janari i këtij viti, nga Qeveria e Maqedonisë deklaruan se "Kthimi i 15 për qind nga pagesa e TVSH-së në xhepin e qytetarëve do të thotë një stimul plotësues për ekonominë e vendit sepse kështu do të rritet fuqia blerëse e qytetarëve. Për llogaritjet e para të bëra nga qeveria janë se një familje do të këtë në xhepin familjar 30.000 denarë, plus brenda një viti duhet të harxhon rreth 200.000 mijë denarë apo në muaj 16.700 denarë. Realizimi i kthimit të këtyre parave do të bëhet përmes kartelave elektronike me të cilat së shpejti do të pajisen të gjithë qytetarët ku do të regjistrohen të gjitha parat për kthim të TVSH-së", thonë nga Qeveria e Maqedonisë.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 23 janar - Kthimi i 15 për qind të tatimit mbi vlerën e shtuar për të gjithë qytetarët që kanë paguar shërbime komunale apo shpenzime për konsum të përgjithshëm, ishte një nga masat që LSDM pat propozuar në fushatën e saj

# Si e ndaluan Amerikanët Gjenocidin në Ballkan



Nga Blerim REKA

Dy dekada pas përfundimit të luftërave ballkanike, Ambasadori Xhejms Perdju na sjell një libër të shkëlqyer, që shpjegon rolin e liderit amerikan për vendosjen e paqes në rajonin historikisht të rrezikshëm të Evropës. Libri ofron dëshmi mbi atë se si diplomacia e SHBA kishte ndaluar gjenocidin në Ballkan, të shkruar nga dëshmitari që ato vite të fundit të shekullit të kaluar, ishte në tehun e politik-bërjes amerikane për rajonin. Duke qenë pjesë e ekipit diplomatik të SHBA, i cili udhëhoqi procesin paqe-krijues në: Bosnje e Hercegovinë, Kosovë e Maqedoni, Perdju ndan me lexuesin dëshmitë e tij personale nga konflikti më shkatërrues në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore.

Libri i tij vjen në 100 vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, te filluar në Sarajevë. Një shekull më vonë, po nga Sarajeva, Ambasadori Perdju do nis misionin e tij diplomatik për tu bërë dëshmitar i ngjarjeve kritike për luftën më të madhe në Evropën e fundit të shekullit XX.

Sipas një simbolike, luftërat e shekullit XX kishin filluar apo përfunduar në Ballkan. Ashtu siç me Luftën e Parë Botërore kishte përfunduar izolacionizmi amerikan, kur Presidenti Uillson kishte shpallur paqen e parë botërore në fillim të atij shekulli; po kështu pas një periudhe hezitimi të SHBA- për tu involvuar në Ballkan - Presidenti Clinton përmes intervenimit diplomatiko- ushtarak, solli paqen në rajon në fund të po atij shekulli. Në vitin 1995, autori ishte në mision diplomatik në shtetin e shpërbërë të ish Jugosllavisë, i cili ishte krijuar pikërisht me Paqen e Versajës, por u zhbë me shpërbërjen e komunizmit Sovjetik. Në pesë pjesët e librit të tij, Pardju, të cilin prof. George Herring, e quan "ushtarak- diplomat", sjell të gjitha: zhvillimet, personalitetet dhe vendet historike që ndikuan në përfundimin e tri luftërave ballkanike në: Bosnje, Kosovë dhe Maqedoni. Me përvojën e tij të pasur diplomatike nga: Vietnami në Japoni; dhe nga Somalia në Ballkan, ai maksimalizoi dy karrierat e tij të suksesshme në më shumë vatra të krizës botërore.

Duke punuar në ekipin e të dërguarit special amerikan për Ballkanin Riçard Holbruk, autori ishte dëshmitar i drejtpërdrejtë i historisë ballkanike të asaj kohe, duke qenë

direkt i involvuar në gjetjen e paqes për luftën e parë në Evropë: pas luftës së ftohtë, pas komunizmit dhe luftën e parë post- ideologjike. "Peacemakers" është një histori e intervenimit të suksesshëm multilateral në Ballkan, që rrëfen pse intervenimet në Bosnje (1995) dhe në Kosovë (1999), i ndryshuan marrëdhëniet ndërkombëtare, duke inauguruar një diplomaci me fytyrë njeriu. Këto dy intervenime humanitare ndërkombëtare, ishin paraardhësit e doktrinës së re të OKB: "responsibility to protect" (R2P), të inauguruar në vitin 2005, të cilat bashkë me ndërmjetësimin aktiv parandalues në Maqedoni (2001); promovuan politikën e jashtme amerikane, bazuar në vlerat njerëzore- si preventive e shkeljes masive të të drejtave të njeriut, spastrimit etnik dhe gjenocidit në nismë.

Libri i Pardjus jep përgjigje në pyetjet kryesore:

- Pse për diplomacinë e SHBA- jo vetëm sovraniteti shtetëror- por edhe ai njerëzor është njëllor i rëndësishëm?
- Pse ekzistenca e njeriut, kishte për këtë diplomaci, të njëjtën vlerë sa edhe ekzistenca e shtetit?
- Pse për diplomacinë amerikane, mbijetesa biologjike e qenieve

njerëzore, që më e rëndësishme se vetëm ruajtja e integritetit territorial të shtetit?

Fatkeqësisht, një dekada pas kësaj historie tragjike ballkanike, bota nuk morri mësim nga pësimi. Sikur të ishte aplikuar modeli intervencionist ballkanik edhe në Siri- pesë vite më herët - atje nuk do i kishim sot përmasat e katastrofës globale. Mësimi që del nga libri i Perdjus është se nuk mjafton vetëm diplomacia në pritje- pa ndërmarrjen e veprimeve ushtarake- për evitimin e katastrofave njerëzore, sepse në të kundërtën na bënë neve po aq përgjegjës. Jo vetëm kryesit e krimit janë përgjegjës, por edhe ata që janë dëshmitar të këtij krimi dhe heshtin, duke mos e parandaluar apo ndalë të njëjtin.

Pardju, në librin e tij pra ngrit dilemën: shteti përballë njerëzimit, apo legaliteti përballë legjitimitetit. Sikur SHBA të ishin udhëhequr vetëm nga legaliteti në marrëdhëniet ndërkombëtare - duke injoruar legjitimitetin, do ta kishin flijuar njerëzimin për reason d' etate. Nga fundi i shekullit XX, bota jonë u bë më komplekse duke qenë e pamundur të shpjegohej vetëm me modelin e sovranitetit klasik Westfalian. Ky është mesazhi crucial i librit të

Mbi librin e James Pardew: "Peacemaker s-American Leadership and the End of Genocide in the Balkans", (University of Kentucky Press, 2018, 424 faqe, ISBN 978-0-8131-7435-8)




Perdju: që vetëm diplomacia e mbështetur me përdorimin selektiv dhe të kujdesshëm të forcës ushtarake, mund ta sjell paqen dhe të shpëtoj njerëzimin.

Prandaj "Peacemakers" i Perdjus, është një histori shkëlqyeshme e rrëfyer nga dëshmitari i asaj historie. Autori nuk ishte vetëm pjesëmarrës i asaj historie të proceseve politike, por edhe autor i shpjegimit të saj. Ai me librin e tij, jep një shembull të jashtëzakonshëm diplomatik, se si duhet parandaluar konfliktet dhe si duhet të arrihet zgjidhja paqësore. Vetëm disa vite pas lansimit të "Agenda for Peace" të OKB-së (1992) dhe të diplomacisë preventive të Butros Butros Galit", Libri i Perdjus tregon se si ajo duhej të funksiononte në realitetin e hidhur dhe jo vetëm në teorinë e idealizuar të marrëdhënieve ndërkombëtare.

"Peacemakers duhet të lexohet jo vetëm nga studentët dhe akademikët, por edhe nga politikë-bërësit dhe diplomatët për ti evituar gabimet në konfliktet e ngjashme, duke siguruar kështu parandalimin e gjenocidit në të ardhmen. Sidomos, mësimet nga ky libër janë të rëndësishme sot, kur paqja botërore po rrezikohet nga një luftë e re e ftohtë dhe nga ri-kthimi i historisë.

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 23 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# Kush mërzitet nga forcimi i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor



Nga Spartak NGJELA

Tre aspektesh janë sot ata që dallojnë të jenë të mërzitur nga forcimi i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor, në funksion të aleancës shqiptaro-amerikane: Të korruptuarit brenda Shqipërisë, Antishqiptarët; dhe Pushuesit e territoreve shqiptare.

I. Sot shihet qartë se që të tre grupet janë të lidhur në interesa vulgare dhe herë-herë shpërthejnë me gënjeshtër frike, që nuk arrijnë ta kuptojnë se shpejt do të bëhen objekt talljeje.

Më qesharakë dallojnë të jenë të korruptuarit dhe antishqiptarët.

Të korruptuarit sot nuk po punojnë: ministra; ish ministra drejtorë të lartë e ish drejtorë, gjithë ditën mendojnë se si të fshehin paratë e vjedhja. Dhe janë në konfuzion tërësor: ku t'i ruajmë? thonë; nëpër banka, po ku, në cilën bankë? Të gjithë vinë vërdallë: ca shohin me shpresë te revolta e Bashkës dhe Saliut e Monikës; të tjerët te Rama, semos ky gjen ndonjë vrimë në Stamboll apo në Moskë; por ka nga ata që po presin një përplasje të nxehtë botërore. Janë krejt të paditur; po të kishin pak njohuri për historinë e shtetit, nuk do të binin në këtë gjendje, nga e cila nuk do të dalin dot.

Si rregull, të gjithë korrupsionet shtetërore që historikisht janë goditur në të gjitha shtetet evropiane, që nga Anglia e Shekullit të Nëntëmbëdhjetë e deri të Italia e viteve 90' të Shekullit që kaloi, janë shkatërruar, pasi pelgu i madh i kor-

rupsionit shtetëror kishte pushtuar të gjithë institucionet dhe revolta popullore mund ta çonte gjendjen në revolucion.

Të gjitha korrupsionet shtetërore në përmasa të mëdha, çojnë në përmbysje të dhunshme, por, edhe Anglia që ishte e para në Perëndim, edhe Italia që ishte e fundit, korrupsionin gjigand e mundën me Reformë. Në fakt reforma italiane thua jse dështoi; kurse reformat e tjera të Vendeve të Ulta; reformat e Vendeve Nordike dhe ajo franceze, e mbyllën çështjen e korrupsionit që në dhjetë vjetshin e parë të Shekullit të XX-të.

Po Reforma shqiptare? Kjo ndodhi edhe këtu: korrupsioni shtetëror masiv duhej fshirë me një Reformë në Drejtësi, e cila do të sjellë reformën institucionale më pas.

Por të katër aspektet e përmendur më lart janë kundër Reformës në Drejtësi.

Ata dallojnë se pikërisht për këtë kanë koneksion veprimesh që vinë nga i njëjti ankh që i ka pushtuar. Janë të bashkuar sidomos antishqiptarët dhe fqinjët pushtues territorësh shqiptarë; por këta të dytë janë në korelacion edhe me korrupsionin e lartë shqiptar, se mendojnë ta shpëtojnë atë për interesat e tyre. Siç kanë bërë në një shekull. Këta fqinjë që kanë uryer historinë mijëra vjeçare të shqiptarëve, por bashkë edhe me antishqiptarët si frymë, kanë 100 vjet që përmendin duke klithur se

Skënderbeu nuk ekziston, se Skënderbeu nuk është shqiptar; se shqiptarët janë turq; e turli pavërtetash të tjera me të cilat sot tallen eruditët e Perëndimit.

II. Të gjithë veglat e Beogradit, Athinës dhe Stambollit, në kor janë hedhur kundër Gjergj Kastriot Skënderbeut, dhe sa nuk thonë se nuk ka pasur dhe nuk ka fare shqiptarë. Por shumë prej tyre janë të ardhur këtu, dhe e dinë ose e ndiejnë këtë. Po pse, Gjergj Kastrioti si figurë ka nevojë edhe për injorancën patologjike që ta njohë historia, kur vetëm sheshe janë në Perëndim përmbi pesëdhjetë me gjithë bustin apo monumentin e tij?

Janë për t'iu qarë hallin. Ka mbi dhjetë mijë vjet që qentë i lehin hënës, e hëna qesh me ta.

Edhe këta qesharakë janë. Kryesorja janë njerëz të mangët nga fantazia; dhe kjo i ka zhytur dhe janë kundër qytetërimit amerikan. Por janë hedhur kundër shqiptarëve se janë në delir, dhe iu duket sikur shqiptarët nuk po u japin vendin e lartë që meritojnë. Nuk e nxjerrin dot mllëfin me Amerikën; dhe kërkojnë të fyejnë shqiptarët, pse po i përkrah tani kaq shumë politika amerikane. Hajde, Hajde! Prisni se do të shihni tetë milionë shqiptarë të bashkuar. Duroni! Se kjo është më e mira rrugë. Janë 68 mijë km<sup>2</sup> në lojë drejt Shqipërisë dhe, mirë grekët e serbët që janë të shqetësuar nga e vërteta për shqiptarët; po këta që jetojnë këtu mirë, çfarë kanë? Se jashtë Shqipëri-

Të gjithë të korruptuarit kur do largohen nga ligji do sjellin çlirimin e shqiptarëve si shoqëri. Por, drejtuesit e nivelit që do të formojnë qeverinë antikorrupsion, do të ngulin në Shqipëri intelektualizmin e luftuar në këta 27 vjet nga Berisha, Nanoja, Meta dhe Edi Rama




së, këta do të ishin nëpër strehënat farfnorë - e pra, këta çfarë kanë?

Por gjithkush që nuk e do zhvillimin modern të Shqipërisë duhet të durojë se do të ketë zhvillime cilësore në këto kohë, sidomos ardhja në Shqipëri e atyre që priten të vinë: harvardasve; e atyre shqiptarëve që kanë mbaruar në Jell, në London School of Economics e në universitete të tjerë prestigjioze perëndimore, dhe, sidomos, ardhja në Shqipëri e menaxherëve shqiptarë që punojnë në institucione të nivelit të lartë në Shtetet e Bashkuara, do t'i mërzisë të tre regjistrat që përmendëm më lart. Ardhja e Shqiptarëve nga Perëndimi do të jetë kushti i madh i bllokimit të injorancës në pushtet. Dhe kjo duhet të jetë skema amerikane, dhe kjo është në fakt. Se janë dhjetra e dhjetra ata që janë përzgjedhur deri tani realisht drejt e po presin të vinë për të implementuar Reformën Shqiptare.

Të gjithë të korruptuarit kur do largohen nga ligji do sjellin çlirimin e shqiptarëve si shoqëri. Por, drejtuesit e nivelit që do të formojnë qeverinë antikorrupsion, do të ngulin në Shqipëri intelektualizmin e luftuar në këta 27 vjet nga Berisha, Nanoja, Meta dhe Edi Rama.

Ardhja e tyre sipas skemës amerikane do të sjellë në Shqipëri shpalljen e falimentimit të antiintelektualizmit shqiptar që mund të thuhet se filloi me Enver Hoxhen; vazhdoi me Sali Berishën dhe përfundoi me Edi Ramën.

## Djem vrasës dhe vajza që ndezin cigare fshehurazi



Nga Alma NIKOLLI

Djemtë ende rriten me idenë se mund të kenë çfarë të duan dhe se mund ta arrijnë me çdo mjet, kurse vajzat në jo pak raste vijnë të bëjnë çfarë duan FSHEHURAZI. E ndezin një cigare në tualet apo banjo dhe e fikin po aty

Nuk është një gjë e mirë hiç, por në të gjithë botën ndodhin makabritete. Fatkeqësisht. Unë s'e kam parë gjithë botën, ama siç ka ndodhur përherë, e keqja merr dhenë sa hap e mbyll sytë, sidomos tani në kohën e virtualitetit.

Në mediat e huaja lexojmë jo pak herë që femijët vrasin prindërit, apo paguajnë njerëz që

t'i vrasin për ta, që prindërit përdhunojnë të vegjlit e tyre, që vajzat vrasin të dashurit apo e kundërta.

Urrejme e traumatizohemi dhe duke vijuar rrjedhën e jetës, duke dashur familjarët që kemi në shtëpi, duke qenë të zënë me pagimin e faturave, harrojmë. Harrojmë dhe jetojmë.

Na dhemb më shumë makabriteti në vendin tonë. Për ne, sh-

qiptari është qenia që dhemb apo urrehet më shumë kur vritet apo vret, domosdo. Por nëse në shumë vende të zhvilluara të tilla ngjarje të rënda lidhen me anoramlitete mendore të abuzuesve dhe vrasësve, në Shqipëri në jo pak raste fajtor është mentaliteti.

"Një student infermierie vret studenten e juridikut sepse ajo nuk iu përgjigj dashurisë që ai

ndiente për të". Ndoshta kaq do të mbahet mend nga tmerrri që hapi edicionet e lajmeve dje dhe sot, nga dhimbja e përjetshme e dy apo më shumë familjeve. Paragjykohe shumë si "klishe" shprehja "Nuk e vrau ai, por e vramë ne-shoqëria", edhe pse për mua këto rreshta përfshijnë shumë të vërteta, për aq kohë sa ka ende prindër që shqetësohen kur linden vajza dhe përderisa pasuritë

modeste familjare u trashëgohen djemve.

Djemtë ende rriten me idenë se mund të kenë çfarë të duan dhe se mund ta arrijnë me çdo mjet, kurse vajzat në jo pak raste vijnë të bëjnë çfarë duan FSHEHURAZI.

E ndezin një cigare në tualet apo banjo dhe e fikin po aty. Ende nuk kanë guxim ta pinë para prindërve. Veç dëmit shëndetësor duhet të shqetësohen edhe për dëmin moral, që zakonisht e përballojnë në mënyrën më të dobët: duke u fshehur. Vajzaaaaaaaa, mos u fshihni më, po iu vrasin gjithsesi. Jetoni sa të mundni!



# FBI BESONTE SE EKZISTONTE EDHE NJË TITO TJETËR!

Markul vizitoi Jugosllavinë në vitin 1953 dhe u takua dy herë me Titon. Takimi i parë zgjati rreth një orë dhe ai vuri re se Tito kishte pesë gishta në çdo dorë. Markul pohon se Titoja i vërtetë humbi gishtin e tij të mesëm dhe gishtin e tij të djathtë. Ai shtoi se Tito me të cilin kishte biseduar në vitin 1953 ishte i arsimuar dhe luante piano. Nga ana tjetër, Titoja i vërtetë ishte e paarsimuar, dhe sipas njohurive të Markul, ai nuk mund të luante në piano

Më 20 prill 1955, Marian John Markul hyri në zyrën e FBI-së në Los Anxhelos dhe tregoi një histori tronditëse. Njeriu i cili përfaqësohej atëherë si Josip Broz Tito nuk ishte me të vërtetë Tito. Ai ishte një agjent rus që mori identitetin e Titos pasi Josip Broz i vërtetë u zhduk në Rusi më 1937, thuhet në shënimet e FBI-së që nga fillimi i majit 1955. Marian Markul u lind në Livno në vitin 1909. Ai u transferua në SHBA në 1936 dhe u bë shtetas pasi shërbeu për dy vjet në Ushtrinë Amerikane. Në shënimet e takimit të agjentëve të FBI dhe Markul, thuhet se Markul vizitoi Jugosllavinë në vitin 1953 dhe u takua dy herë me Titon. Takimi i parë zgja-

ti rreth një orë dhe ai vuri re se Tito kishte pesë gishta në çdo dorë. Markul pohon se Titoja i vërtetë humbi gishtin e tij të mesëm dhe gishtin e tij të djathtë. Ai shtoi se Tito me të cilin kishte biseduar në vitin 1953 ishte i arsimuar dhe luante piano. Nga ana tjetër, Titoja i vërtetë ishte e paarsimuar, dhe sipas njohurive të Markul, ai nuk mund të luante në piano.

Ndër të tjera, Markul pretendon se Josip Broz ishte rreth 180 centimetra i gjatë, ndërsa Tito i rrem ishte vetëm 160 cm. Markul gjithashtu tha se njeriu i cili në vitet 1950 ishte prezantuar si Tito fliste me një theks të butë rus, ndërsa Titoja i vërtetë fliste me

vendosmëri dhe ashpërsi. Markul pohon se Titoja i vërtetë ishte i sëmurë dhe kishte tuberkuloz, dhe u zhduk në Rusi më 1937. Pas pranimi për takim me Titon në vitin 1953, Marian vizitoi një motër të martuar në Zagreb. Ata hezitonin të flisnin për atë nëse Tito ishte ai i vërteti, apo nuk ishte. Motra i tha Markul se ajo dhe burri i saj jetonin me bindjen se Tito në rrugën 15 ishte një mashtrues i zakonshëm. Markul shtoi se babai i tij, Ivan Markul, kishte një mendim të ngjashëm. Ivan Markul dhe Josip Broz kishin punuar në të njëjtin qytet dhe Ivan ishte i bindur se Tito në Beograd nuk ishte i njëjtë me shokun Tito - sekretar i Partisë Ko-

muniste në Jugosllavi.

Markul vetë tha se ai kaloi disa vite në Rusi dhe se kishte parë shumë agjentë rusë në rrugët e Jugosllavisë. Në vitin 1930, ai shkoi në Rusi dhe mendoi se shoqëria ishte mirë e organizuar, por u arrestua për shkak se nuk i plotësonte kuotat e punës. Ai u tha agjentëve amerikanë se ai kishte ikur nga Rusia tre vjet më vonë, nëpërmjet Siberisë. "Markul argumenton se autoritetet jugosllave po bëhen kinse kanë mosmarrëveshje me BRSS për të marrë ndihmë nga SHBA dhe se në fakt nuk ka mosmarrëveshje të vërtetë midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik", thuhet në dokumentin e FBI-së.

## 15-vjeçari shtiret si drejtor i CIA-s, donte të vidhte top-sekrete nga ushtria amerikane

Adoleshenti posedonte fjalëkalimet, informatat personale, detajet e sigurisë, listën e kontakteve dhe dokumente të ndjeshme lidhur me aksionet në Afganistan dhe Irak



Një haker fillorist është shtirur si drejtor i CIA-s për të pasur qasje në raportet top-sekrete të ushtrisë amerikane. Kane Gamble ishte vetëm 15-vjeçar kur vepronte si shefi i CIA-s, John Brennan nga shtëpia e tij në Leicestershire të Anglisë. Ai, madje kishte edhe kon-

troll në iPadin e gruas së shefit të CIA-s. Adoleshenti posedonte fjalëkalimet, informatat personale, detajet e sigurisë, listën e kontakteve dhe dokumente të ndjeshme lidhur me aksionet në Afganistan dhe Irak. Gamble, i cili themeloi grupin pro-palestinez

"Crackas With Attitude", u tall me shërbimin e sigurisë në Twitter për sukseset e tij. Gjatë sulmeve të tij në internet, të cilat filluan nga qershori i vitit 2015, ai bëri thirrje të rrejshme te familja e Brennanit dhe kishte kontroll në iPadin e gruas së tij. Viktima tjera të tij ishin

edhe Mark Giuliano i FBI-së, Jeh Johnson e James Clapper të sigurisë kombëtare dhe drejtori i Intelgjencës Kombëtare në kohën e Barack Obamas.

Gamble përdori emailin e Clapperit për të dërguar mesazhe të zyrtarët tjerë. Ai krenohet me thyerjen më të mirë të sigurisë kur kishte qasje në databazën e FBI-së nga e cila mori 1 mijë emra të stafit të saj. Përmes informacioneve që mbledhi Gamble më vonë i përdori si kërcënim ndaj John Holdren, këshilltar për shkencë dhe teknologji i presidentit Obama. Këto thyerje të sigurisë i kushtuan qeverisë 40 mijë dollarë dhe pësoi dëme të reputacionit. Gamble u arrestua në shkurt të vitit 2016 pas kërkesës së FBI-së. Ai është shpallur fajtor për tetë akuza dhe do të mbahet edhe një seancë gjyqësore në të cilën do të shpallet dënimi i tij.

## Britanikët qëndrojnë 3 orë në tualet, ndërsa vetëm 90 minuta në aktivitete fizike

Një studim i ri thotë se britanikët kalojnë më shumë kohë në tualet se duke bërë ushtrime. Ata kalojnë mesatarisht tri orë dhe nëntë minuta në javë në tualet dhe vetëm 90 minuta në javë në aktivitete. 64% e tyre ulen për të paktën gjashtë orë para kompjuterit ose thjesht duke parë televizor. Për të arritur te këto statistika është bërë një seri sondazhesh, duke pyetur rreth dy mijë të rritur. Interesant është fakti se vetëm 12% e tyre e dinë se sa ushtrime u duhen për të mbajtur trupin në formë. Nëse nuk e dini as ju që po lexoni këtë shkrim, duhen 150 minuta ushtrime në javë (ecje me biçikletë, not apo ecje sportive).

Rrjetet sociale, ndërkohë, po ndikojnë shumë në sensibilizimin e njerëzve për të bërë ushtrime. 41% e të rinjve janë përgjigjur se fotot e personazheve VIP në palestër i nxisin, por kjo përgjithësisht nuk vlen për moshat mbi 24 vjeç. Steven Ward, shefi ekzekutiv i UKActive-s, thotë: "Trupi i njeriut është bërë për të lëvizur, por jeta moderne i ndalon njerëzit të kenë aktivitet fizik. Ne kalojmë më shumë kohë duke shpenzuar, se sa duke u djersitur. Shqetësimi më i madh është pikërisht ky. Këtë mungesë ekuilibri po e shkakton edhe përdorimi i celularëve gjatë gjithë kohës". Profesori Sir Mui Gray, ndërkohë, alarmon: "Mungesa e aktivitetit fizik është vrasësi i heshtur i shoqërisë. Sa më shumë të qëndrosh ulur, aq më shumë sëmundje mund të kesh. Njerëzit mendojnë se ushtrimet janë vetëm për të rinjtë, por kjo është e gabuar".



Shkencëtarët nga Universiteti i Leeds dhe Instituti për Hulumtime të kancerit në Londër me këtë rast vërtetuan se viruse të zakonshëm, sikur ata që ndodhen në natyrë dhe nuk i sulmojnë kafshët apo bimët, mund të veprojnë si terapi imuniteti në trajtimin e tumoreve të trurit

# KANCERI NË TRU MUND TË SHËROHET ME VIRUSE



Problemi i vetëm për shkencëtarët ishte si t'i vendosnin viruset në tumor, por patën sukses. Kishte nëntë prej tyre, të gjitha në një rresht për operimin e gliomave dhe tumore të tilla të trurit të cilat prognozat ishin shumë të këqija. Nuk kishte asgjë për të humbur, dhe kështu, pak ditë para operacionit, ata injektuan në damarët e gjakut përmes dozës me reoviruse. Kur pas operimit hoqën tumorin dhe i analizuan, panë se në vetëm pak ditë tumoret me sa duket kishin pësuar një dëmtim në nivel qelizor, për shkak të "një arsyeje", natyrisht.

Shkencëtarët nga Universiteti i Leeds dhe Instituti për Hulumtime të kancerit në Londër me këtë rast vërtetuan se viruse të zakonshëm, sikur ata që ndodhen në natyrë dhe nuk i sulmojnë kafshët apo bimët, mund të veprojnë si terapi imuniteti në trajtimin e tumoreve të trurit. Artikulli shkencor me detajet e këtij zbulimi fantastik u botua nga Science Translational Medicine.

Shkencëtarët janë të bindur se në këtë mënyrë mund t'i trajtojnë tumoret, pasi viruse janë treguar të infektjnë vetëm qelizat e tumorit dhe të mos prekin qelizat normale.

Problemi me tumoret e trurit deri tani ka qenë që besohej që viruset nuk mund të jenë në gjendje të depërtojnë nga damarët e gjakut në tru për shkak të barrierës që mbron trurin. E vetmja mënyrë mbeti vendosja direkte e virusit në tru, por ajo ishte e rrezikshme dhe nuk duhej marrë parasysh. Tani shkencëtarët kanë arritur të dërgojnë virusin përmes damarëve të gjakut në tru. Pas nxjerrjes së tumoreve dhe vendosjes së tyre nën mikroskop, ata kuptuan se reoviruset, kur kishin arritur qelizat tumorale, kishin provokuar sistemin

imunitar të organizmit. Për aq kohë sa viruset nuk ishin në qelizat tumorale, trupi i qelizave nuk e përjetonte atë si diçka që ngadalë vret trupin e njeriut. "Sistemi ynë imunitar nuk është veçanërisht i mirë në 'përballimin' e kancerit, pjesërisht për shkak se qelizat e kancerit ngjasojnë me qelizat e shëndetshme dhe pjesërisht për shkak se qelizat e kancerit janë shumë të afta në atë se si t'u 'thonë' qelizave të sistemit imunitar për t'u kthyer në anën tjetër", shpjegon Alan Mercher, një nga shkencëtarët që morën pjesë në këtë studim.

Por në këtë rast, me përdorimin e reovirusit në kancerin e trurit, kur virusi u gjet në një qelizë, organizmi papritur u mbërthe në bombardimin e limfociteve të infektua-

ra dhe vrasjen e tyre. Organizmi çdo qelizë të tillë pa gabim e detektoi si të rrezikshme. Shkencëtarët kanë gjetur në indin e prekur nga reoviruset nivele të larta të interferonit, një proteinë që aktivizon sistemin e mbrojtjes të trupave tanë, një nga mrekullitë që Gregory House përmend herë pas here në serinë popullore. Ky sukses me vendosjen e reovirusit në tumoret e trurit hap të gjitha llojet e zgjidhjeve dhe si një imunoterapi autonome për kancerin, jo vetëm të trurit, por edhe si terapi shtesë pas operacionit dhe gjatë kimioterapisë. Efektet anësore? Pacientët raportuan se kishin simptoma të ngjashme me atë të gripit me intensitet afërsisht të mesëm, i cili kalonte brenda disa ditëve.



## 10 vendet që paguajnë më shumë mësuesit

Edukimi dhe arsimimi i brezave të rinj është shtylla kryesore që garanton jo vetëm mbijetesën e një populli, por edhe rritjen e mirëqenies së tij. Sado të ndryshojnë prioritetet e një qeverisjeje, arsimimi është gjithnjë e aty, njëri prej tyre, madje edhe kur bëhet fjalë për vendet më të zhvilluara të planetit. Por cilat janë vendet që vlerësojnë më shumë ata që përhapin dijen tek brezat e rinj? World Economic Forum ka bërë renditjen e 10 vendeve që paguajnë më shumë mësuesit në bazë të të dhënave të publikuara nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik:

- 1. LUKSEMBURG.** Paga vjetore e një mësuesi është 79 mijë dollarë. Për ata me përvojë shkon deri në 137 mijë dollarë.
- 2. ZVICRA.** Paga vjetore e mësuesve në këtë vend është 69.865 dollarë.
- 3. GJERMANIA.** Paga vjetore për mësuesit 61.589 dollarë
- 4. NORVEGJIA.** Paga vjetore për mësuesit është 47.445 dollarë
- 5. DANIMARKA.** Paga vjetore për mësuesit është 46.914 dollarë
- 6. SHBA.** Paga vjetore për mësuesit është 43.678 dollarë
- 7. SPANJË.** Paga vjetore për mësuesit është 42.002 dollarë
- 8. AUSTRALIA.** Paga vjetore për mësuesit është 40.874 dollarë
- 9. HOLANDA.** Paga vjetore për mësuesit është 39.205 dollarë
- 10. KANADA.** Paga vjetore për mësuesit është 39.179 dollarë.

## Toka po largohet nga Dielli

Dielli është duke humbur ngadalë fuqinë tërheqëse që ka ndaj planetëve, e për pasojë edhe Toka është duke u larguar prej tij. Këtu nuk ka vend për panik, pasi siç sqarojnë autorët e një studimi të fundit, Toka largohet çdo vit me 1.5 centimetra nga Dielli. Antonio Genova i Qendrës Hapësinore Goddard të NASA-s shpjegon se përlloraritja është bërë në bazë të të dhënave të përfituara nga sonda

Messenger e Agjencisë Hapësinore Amerikane. "Dielli është duke humbur masën e tij si pasojë e stuhive diellore. Sa më shumë stuhi të tilla të ndodhin në sipërfaqen e yllit tonë, aq më e dobët bëhet fuqia ekuilibruese e tij në sistem", thotë Genova. Sipas këtij studimi, sa më e madhe të jetë masa e një planeti dhe distanca e tij nga Dielli aq më shumë thellohet. Si shembull Genova sjell Jupiterin. "Jupiteri është



në një distancë 10 herë më të largët se Toka nga Dielli dhe largohet me 14 centimetra çdo vit prej tij", shpjegon ai. Shkencëtarët parashikojnë se Dielli është në proces shndërrimi

në një gjigant të zjarrtë, që do të thotë se nuk do të përçojë dot më tek planetet e sistemit ngrohtësinë e tij. Ky proces pritët të realizohet për rreth 5 miliardë vite.

## Zbulohen aplikacionet që vjedhin fjalëkalime në Facebook

Ekspertët e sigurisë kompjuterike kanë zbuluar një problem të ri, të quajtur GhostTeam, në së paku 56 aplikacione në dyqanin e Google Play. GhostTeam dedikohet për vjedhjen e emrave të përdoruesve dhe fjalëkalimeve në Facebook. Ai fshihet në formën e aplikacionit për baterinë e llambës, kompasit, skanerit dhe kodeve QR, pastrimit të telefonit të mençur, argëtimeve në forma të ndryshme dhe shkarkimeve të

videove. Siç ndodh shpesh, vetë aplikacionet nuk përmbajnë kod me qëllim të keq, andaj lejohen të përfshihen në katalogun e Google Play.

Ky 'malware' mbledh informacione rreth pajisjes, vendndodhjen, gjuhën dhe parametrat e shfaqjes. Sa më shpejt që ju të hapni aplikacionin në Facebook, ai do të kërkojë serish nga ju kyçje në formë verifikimi, por kur ju do të shkruani emrin e përdoruesit

dhe fjalëkalimin, ato të dhëna do t'i dërgohen autorit të virusit. GhostTeam është zbuluar nga Avast dhe Trend Micro. Besohet se kjo është një çështje e punës së një zhvilluesi vietnamez, pasi gjuha vietnameze është përdorur për të shkruar kodin e kompjuterit. Aktualisht, përdoruesit e Android në Indi, Indonezi, Brazil, Vietnam dhe Filipine janë në rrezik më të lartë, shkruan Hacker News.



# “VULOSET” NDARJA E VETËEVENDOSJES

Përplasjet në Vetëvendosje dolën në sipërfaqe pas publikimit të bisedave private ndërmjet disa deputetëve të këtij subjekti politik, ku kishte edhe shprehje fyese në drejtuara ndaj Albin Kurtit

Zgjedhja e Albin Kurtit për kryetar të Lëvizjes Vetëvendosje ka vulosur ndarjen e këtij subjekti politik, vlerësojnë analistë politikë. Kurti, u rikthye në krye të Vetëvendosjes, në kohën e dorëheqjeve të shumë personaliteteve nga ky subjekt politik, i cili po kalon një prej fazave më të vështira që nga themelimi.

Të dielën, në këtë Lëvizje janë mbajtur zgjedhjet e brendshme dhe nga rezultat e shpallura, Albin Kurti ka marrë 98.82 për qind të votave të anëtarëve pjesëmarrës në këto zgjedhje. Por, në këtë garë zgjedhore, Albin Kurti ka qenë i vetmi kandidat për kryetar. Imer Mushkolaj, analist politik në një bisedë për Radion Evropa e Lirë, tha se rikthimi i Albin Kurtit në krye të Lëvizjes Vetëvendosje do thellojë edhe më tepër përçarjet dhe mospajtimet në këtë subjekt politik, kurse mundësitë që të arrihet pajtimi në mes të grupeve brenda Vetëvendosjes, sipas tij, janë jashtëzakonisht të vogla. “Zgjedhja e Kurtit kryetar, i ka dhënë një vulë të fundit ndarjes së Lëvizjes Vetëvendosje. Dhe, përderisa deri tash është folur për mo-



spajtime apo pakënaqësi të thella, tashmë mund të flasim vetëm për ndarje të këtij subjekti politik”, tha Mushkolaj.

Edhe Krenar Gashi, studiues i shkencave politike, tha për Radion Evropa e Lirë se nuk sheh ndonjë mundësi që zgjedhja e Albin Kurtit kryetar të jetë zgjidhje e problemeve të Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas Gashit, të dorëhequrit nga postet e larta drejtuese nuk kanë probleme madhore me Albin Kurtin si kryetar, por problemet kanë të bëjnë me mënyrën si merren vendimet brenda strukturave të partisë. Këto vendime, nënvizon ai, datojnë pikërisht nga koha kur Albin Kurti merrte vendime, siç thotë ai, përderisa ishte nën hije. “Duke marrë parasysh që Kurti ka përdorur një diskurs tejet përjashtues, një diskurs absolutisht totalitar ndaj të gjithë atyre që kanë guxuar të mendojnë ndryshe dhe që kanë guxuar më në fund që këtë mendim ndryshe ta shfaqin në publik, unë jam shumë pesimist se mund

të gjendet një zgjidhje me të cilën do të mund të pajtoheshin të dy palët apo më shumë palë”, thotë Gashi.

Subjekti më i madh opozitar në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje, ka kohë që po përballlet me probleme të brendshme, përçarje e mospajtime. Nga postet e larta drejtuese, tashmë kanë dhënë dorëheqje personalitete të njohura politike, duke përfshirë ish-kryetarin, Visar Ymeri, nënkryetarin Dardan Sejdiu dhe anëtarë tjerë të këtij subjekti politik, të cilët nuk kanë marrë pjesë as në votimin për kryetarin e ri të Vetëvendosjes. Nisur nga këto zhvillime në Vetëvendosje, analisti Imer Mushkolaj, thotë se funksionimi i përbashkët i këtij subjekti po duket i pamundur. Kështu që ai mendon se të dorëhequrit do të formojnë një subjekt të ri politik.

“Por e rëndësishme, për opinionin dhe qytetarët është se me çfarë platforme do të paraqiten, të shpjegojnë saktësisht se cili është

dallimi i subjektit të ri politik dhe Lëvizjes Vetëvendosje, sidomos kur bëhet fjalë për tema për të cilat Lëvizja Vetëvendosje është shquar”, thekson Mushkolaj. Duke pas parasysh dallimin shumë të madh konceptual që po shfaqet brenda subjektit, Krenar Gashi, në anën tjetër, konsideron se si rezultat, kriza mund të zgjasë për një kohë ose do të ketë shpërbërje të disa individëve nga Vetëvendosje. “Meqë kemi të bëjmë me figura të rëndësishme të Lëvizjes, me figura që janë pjesë e Grupit Parlamentar dhe që kanë pozita tjera dhe që kanë fituar përmes garës elektorale, atëherë domosdo pritet që këta njerëz të vazhdojnë aktivitetin politik duke formuar një parti të re politike ose forcë të re politike”, tha Gashi për Radion Evropa e Lirë. Përplasjet në Vetëvendosje dolën në sipërfaqe pas publikimit të bisedave private ndërmjet disa deputetëve të këtij subjekti politik, ku kishte edhe shprehje fyese në drejtuara ndaj Albin Kurtit.

## Demarkacioni duhet të ratifikohet me urgjencë

Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian iu kanë kërkuar sërish institucioneve të Kosovës që Marrëveshja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi të ratifikohet brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Këtë komente janë bërë gjatë prezantimit të prioriteteve të presidencës bullgare të Bashkimit Evropian në Kosovë. Fokus i presidencës bullgare, sipas ambasadorit, Nedialtço Dantchev, vihet tek lidhjet e Ballkanit Perëndimor me BE-në, pastaj e ardhmja e Evropës dhe të rinjve, rritja ekonomike, siguria dhe stabiliteti në një Evropë të fort dhe të bashkuar. Me fillim të këtij viti Bullgaria ka marrë udhëheqjen e presidencës së Bashkimit Evropian, duke u bërë vendi i parë nga Ballkani që merr një pozitë të tillë për gjashtë muajt e ardhshëm. Shefja e zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se marrëveshja e demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi duhet të ratifikohet si çështje e interesit nacional për të ndaluar vet izolimin. Ajo ka bërë të ditur se me strategjinë për zgjerimin e Ballkanit Perëndimor që do të vijë në shkurt dhe prezantimi i raportit për Kosovën në prill, Kosova, siç thotë Apostolova ‘ka mundësi që të demonstrojë përkushtimin për vlerat evropiane dhe të prezantojë një imazh pozitiv pjesës tjetër të Evropës’. “Kosova duhet të shfrytëzojë këtë mundësinë unike duhet të ratifikojë marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Kjo do të jetë një sinjal i vërtetë që Kuvendi po punon në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Marrëveshja e demarkacionit duhet të ratifikohet si çështje e interesit nacional për të ndaluar vet izolimin e Kosovës dhe të ecim përtej interesave personale të disa qarqeve politike”, thotë Apostolova.

## Çështja e Kosovës në fazë historike, Kisha serbe dëshiron të bëhet pjesë

Kisha Ortodokse Serbe e konsideron se çështja e Kosovës ndodhet në fazën historike, ndërsa ajo dëshiron të jetë pjesë e kësaj historie. Gjashtë peshkopë të Kishës Ortodokse Serbe (SPC) kanë kërkuar nga Sinodi që të caktojë Kuvendine SPC-së në mënyrë që kisha të deklarohet dhe të marrë

qëndrim unik për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, shkruan e përditshmja e Beogradit, “Blic”, duke cituar burime nga Patrikana. Çështja e Kosovës po hyn në fazën e saj finale dhe është e domosdoshme që kisha të përcaktohet ndaj zhvillimeve. Kisha duhet të thotë me një gojë se cili është kufiri deri

ku po shkojmë, të bëjë publike qëndrimin e kuvendit kishtar në situatën në të cilën ndodhet populli dhe shteti, citon kjo gazetë njërin nga peshkopët. Ai është shprehur se ky njëmend është moment historik dhe se ka nevojë për një qëndrim të tillë historik të kishës rreth çështjes më madhore, i



cili do t'i bëhet i ditur popullit dhe shtetit. Theksohet se mbajtja e Kuvendit nuk është as për, as kundër

presidentit Vuçiq dhe se do të ishte gabim nëse interpretohet ashtu, përfundon “Blic”.

# HEBRENJTË E PADËSHIRUAR TË FRANCËS!

Gjithnjë e më shumë hebrej ndihen të braktisur nga shteti francez dhe po emigrojnë në Izrael. Vetëm në vitin 2016 nga Franca u larguan rreth 5000 hebrej

Këtu Azizi shiste deri para pak ditësh ushqim kosher për komunitetin hebre në periferi të Parisit në Creteil. Tani pas zjarrit në rafte nuk ka mbetur më asgjë. Azizit i ishin dashur vite për ta ngritur dyqanin e tij. "Ky ishte fëmija im, këtu punoja 12 deri në 15 orë në ditë. Tani gjithçka është bërë shkumb e hi", thotë Azizi duke treguar drejt dyqanit të shkatërruar. Ai ka frikë prej sulmesh të tjera, sepse prej disa javësh, muret e dyqaneve të hebrejve po mbushen me kryqe të thyer. Kështu edhe dyqani i Azizit, megjithë se ai sikurse thotë nuk është çifut, por mysliman dhe berber nga Algjeria. "Më duket sikur ma kanë pikturuar kryqin e thyer në shpinë. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me dëmtimin e pronës, unë ndihem i kërcënuar personalisht. Dhe tani e di edhe më mirë si ndjehen hebrejntë".

## SULME TË PËRSËRITURA NDAJ HEBRENJVE

Në Creteil jetojnë rreth 15.000 hebrej si dhe një bashkësi shumë



më e madhe muslimanesh. Gjatë viteve të fundit ka pasur sulme të përsëritura ndaj hebrejve. Autorët ishin më së shumti myslimanë të rinj. Por askush nuk dëshiron të flasë hapur për këtë, as tregtari hebre Ilan Fitoussi, me të cilin Azizi ka miqësi. "Nuk dua të akuzoj askënd këtu, kam marrëdhënie të mira me si me ata nga Afrika e Veriut dhe me afrikanët me ngjyrë. Unë dua vetëm të them se konflikti midis izraelitëve dhe palestinezëve duhet të zhvillohet në Lindjen e Mesme dhe jo këtu te ne", thotë

Ilan Fitoussi. Mënjanimi i konflikteve po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Sepse vitet e fundit në Francë po përhapet gjithnjë e më e fortë një propagandë anti-hebreje, thotë historiani Rudy Reichstatt, i cili ka themeluar për këtë arsye shoqatën "Watch Conspiracy". "Çdo gjë e keqe që ndodh në botë shpjegohet me ndonjë komplot hebre. Për shembull, sulmet në Francë dhe gjetkë në Evropë, apo edhe krizat ekonomike apo kryengritjet popullore. Madje edhe kur vdes ndonjë njeri i famshëm, lindin dyshime. Pas të gjithave duhet të

ketë ndonjë hebre, nga ata që kanë në dorë fijet e historisë", thotë historiani Rudy Reichstatt. Një nga zjarrvënësit shpirtërorë më të rrezikshëm në Francë është Alain Soral. Publicist dhe botues që e quan veten "nacional-socialist" dhe ka ribotuar së fundi librin e Hitlerit "Mein Kampf". Faqen e tij të internetit e vizitojnë çdo muaj pesë milionë vetë. Fare hapur, Soral përpjetet të joshë edhe muslimanët e rinj me parulla si "çifutët janë sundimtarët e fshehtë të botës"; "ata janë në krye dhe ne jemi në fund"; "ata janë si një sekt dhe kujdesen

vetëm për njerëzit e tyre"... Prillin e kaluar, një musliman i ri i droguar hyri me dhunë në këtë rrugë të Parisit në shtëpinë e mjekes hebreje, Sarah Halimi. Ai e torturoi atë brutalisht, e hodhi pastaj prej dritares duke e quajtur "Satan". Avokati i familjes ka bërë gjithçka të mundshme që ky krim të klasifikohet si "krim antisemitik". "Nëse nuk do të kisha kërkuar ndihmë nga shtypi dy muaj pas krimit, ndoshta mund të mos nisej as edhe ndonjë gjykim. Sepse do të thoshin se djali ishte në delir dhe nuk ia vlen ta dënosh dhe pas kësaj askush nuk do të fliste më për këtë", thotë avokati.

## FRIKË NGA SHTIMI I ANTISEMITIZMIT

Është pikërisht ky kthim i kokës mënjane që i fut sidomos frikën bashkësisë hebraike. Eva Tangier e njihte mirë Sarah Halimin. Ashtu si shumë nga të njohurit e saj, edhe ajo e ndjen se për hebrejntë po bëhet gjithnjë e më e rrezikshme në Francë: "Unë personalisht ndihem e kërcënuar. Sepse në Francë sot ekziston një klimë e përgjithshme naiviteti dhe indiference. Për të mos rrezikuar paqen sociale disa veprime të caktuara thjesht harrohen". Kthehemi në Creteil. Myslimani Aziz dhe miku i tij hebre janë të një mendjeje se indiferenca nuk mund të jetë zgjidhje. Të gjithë francezët duhet të përballen me këtë problem me guxim dhe mbi të gjitha së bashku. (DW)

## Borë, kryetarë shtetesh, artistë - të gjithë në Davos të Zvicrës

Miliarderë, kryetarë shtetesh dhe udhëheqës korporatash mblidhen këtë javë në Davos të Zvicrës, për Forumin Ekonomik Botëror. Mbi 60 kryetarë të shteteve dhe qeverive, përfshirë presidentin amerikan, Donald Trump, pastaj qindra liderë të bizneseve, akademike, artistë dhe përfaqësues të shoqërisë civile do të takohen për katër ditë, nisur nga dje, nën moton "Krijimi i një të ardhmeje të përbashkët në një botë të çarë". Me ekonominë globale në rritje, me mesataren industriale të indeksit Dow Jones mbi 26,000 pikë për herë të parë dhe me optimizmin se rishikimi i sistemit të taksave në SHBA do të rrisë të ardhurat e korporatave, pritjet e pjesëmarrësve në samit duken të larta.

Por, bora e madhe në Alpe e ka bërë udhëtimin të vështirë në shumë rajone dhe Zvicra ka lëshuar alarmin e ortekëve më 22 janar. "Jam i lumtur për borën, sepse i jep Davosit atë që duhet të ketë aspektin e një fshati global, një fshati ku natyra luan ende rol të



Brenda sallave të forumit do të mbahen rreth 400 debate dhe panele me tema si: rritja ekonomike, mjedisi, terrorizmi, inteligjenca artificiale, parashikimet për Afrikën dhe mënyrat se si refugjatët mund të kontribuojnë në vendet mikpritëse

rëndësishëm", tha kryetari i Forumit, Klaus Schwab, në një intervistë për agjencinë Reuters. Brenda sallave të forumit do të mbahen rreth 400 debate dhe panele me tema si: rritja ekonomike, mjedisi, terrorizmi, inteligjenca artificiale, parashikimet për Afrikën dhe mënyrat se si refugjatët mund të kontribuojnë në vendet mikpritëse. Një dekadë pasi falimentimi i bankës amerikane të investimeve

Lehman Brothers ka ndihmuar në nxitjen e krizës globale financiare, duke zhytur ekonomi të shumta në recesion, Trump pritet të dominojë shumë biseda edhe para fjalimit të tij në ditën e fundit. Protesta të vogla tashmë janë mbajtur, ndërsa autoritetet kanë refuzuar kërkesën e grupeve majtiste për të protestuar në Davos më 25 janar, duke thënë se nuk ka hapësirë të mjaftueshme për shkak të

reshjeve të borës. Megjithatë, një peticion anti-Trump, i cili i bën thirrje presidentit amerikan të qëndrojë larg, ka mbledhur mbi 16.000 mbështetës online. Ndalmi i protestës është "një mënyrë e fshehtë pas fuqisë së elitave globale", tha Tamara Funicello, udhëheqëse e Socialistëve të Rinj të Zvicrës, duke shtuar se autoritetet "kanë nevojë për shtylla më të forta". Policia zvicerane ka shpërndarë mbi 4300 oficerë në rajon për të ofruar siguri.

Këngëtarë Elton John dhe aktorja Cate Blanchett janë vetëm dy nga dhjetëra celebritetë që pritet të marrin pjesë në forum, me qëllim rritjen e vetëdijes për çështjet sociale. Forumi këtë vit do të përfshijë edhe disa sesione për ngacmimet seksuale, sidomos në industrinë e filmit. I përballur me akuzat për seksizëm, Forumi Ekonomik Botëror ka emëruar këtë vit shtatë bashkëkryesues gra, përfshirë Christine Lagarde, shefe e Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe Ginni Rometty, shefe ekzekutive e IBM-së.

Në bazë të nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Tekst i pastuar) ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15) në v. v me nenin 18 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 6 e Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 43/14) dhe nenit 40, 41, 43-a, 43-b, nenit 80, nenit 81 dhe nenit 95 të Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës 02 Su. nr. 21/15 të datës 15.05.2015, 02 Su. nr. 30/15 të datës 26.06.2015 dhe Su. nr. 30/15-1 të datës 15.10.2015, Gjykata themelore Shkup 1 Shkup më datë **24.01.2018** publikon

SHPLLJE PUBLIKE nr. 1/2018

Për punësim të nëpunësit gjyqësor për kohë të caktuar

**1. Bashkëpunëtor i ri – koordinator për mirëmbajtje teknike të ndërtesës gjyqësore – kategoria V4, 3 (tre) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**  
- Të arritura së paku 180 kredi sipas SETK – Fakulteti juridik ose fakultet tjetër

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (angleze, frënge ose gjermane), me shkallë përkatëse të njohjes në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 i Ligjit për shërbim gjyqësor.

Pagesa bazë 21.823,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

**2. Bashkëpunëtor i ri – në departamentin për resurse njerëzore – kategoria V4, 1 (një) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**

- Të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 – Fakulteti juridik ose fakulteti filozofik – administrata publike dhe veprimtaritë sociale ose fakultet nga sfera përkatëse

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (angleze, frënge ose gjermane), me shkallë përkatëse të njohjes në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 i Ligjit për shërbim gjyqësor.

Pagesa bazë 21.823,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

**3. Bashkëpunëtor i ri gjyqësor – analist – kategoria V4, 2 (dy) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**

- Të arritura së paku 240 kredi sipas SETK – Fakulteti juridik ose shkallë të VII/1 të mbaruar fakultet juridik

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (angleze, frënge ose gjermane), me shkallë përkatëse të njohjes në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 i Ligjit për shërbim gjyqësor.

Pagesa bazë 23.061,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

**4. Bashkëpunëtor i ri gjyqësor – kategoria V4, 8 (tetë) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**

- Të arritura së paku 240 kredi sipas SETK – Fakulteti juridik ose shkallë të VII/1 të mbaruar fakultet juridik

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (angleze, frënge ose gjermane), me shkallë përkatëse të njohjes në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 i Ligjit për shërbim gjyqësor.

Pagesa bazë 23.061,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

**5. Referent i ri gjyqësor – kategoria G4, 5 (pesë) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**

- Së paku arsim të lartë ose të mesëm

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (angleze, frënge ose gjermane), me shkallë përkatëse të njohjes në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 i Ligjit për shërbim gjyqësor.

Pagesa bazë 15.157,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

**6. Referent i ri gjyqësor – daktilografi - kategoria G4, 4 (katër) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**

- Së paku arsim të lartë ose të mesëm

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më shpesh të Bashkimit Evropian (angleze, frënge ose gjermane), me shkallë përkatëse të njohjes në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 i Ligjit për shërbim gjyqësor.

Pagesa bazë 15.157,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

**7. Mirëmbajtës të higjienës – 2 (dy) realizues**

**Kualifikimet profesionale:**

- Arsimit fillor ose të mesëm

**Përvoja e punës:**

- me ose pa përvojë pune

Pagesa bazë 11.929,00 denarë;

Orë të punë në javë 40;

Orari i punës: prej 07:30 deri më 15:30;

Pushimi ditor (pauza): prej ora 11:00 deri në ora 11:30

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar gjegjësisht deri më 31.12.2018

Krahas kushteve të posaçme të theksuara, të parapara në Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkup 1 Shkup, kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme për punësim, të parapara në nenin 21 të Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 43/14) edhe atë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;

- Të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;

- Të jetë i moshës së rritur;

- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;

- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Afati për paraqitjen e kandidatëve është 5 (pesë) ditë, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet ti plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Kandidatët e interesuar janë të obliguar të parashtrojnë lutje për punësim (CV dhe letër motivimi) si dhe dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Kandidatët janë të obliguar që në lutje të japin të dhëna të plota, precize dhe të sakta me dhënie të domosdoshme të emrit dhe mbiemrit, adresa banimit, adresa për kontakt, vendi i punës dhe numri i shpalljes për të cilin kandidati paraqitet si dhe e-mail adresë dhe numri i tyre i telefonit për kontakt.

Lutjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

Pas kalimit të afatit për paraqitje, zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afatin e caktuar në nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Kandidatët e interesuar fletëparaqitjen gjegjësisht lutjen mund ta dorëzojnë në formë të shkruar përmes departamentit për pranim të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup ose përmes postës në adresën bul. Goce Dellçev nr. 10, Shkup (me shënim për Shpallje publike për punësim nr. 1/2018).

GJYKATA THEMELORE SHKUP 1 SHKUP

Në bazë të nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 18 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 6 i Ligjit për shërbim gjyqësor, si dhe nenit 17, nenit 21, nenit 25, nenit 26, nenit 44, nenit 46, nenit 54 dhe nenit 55 të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkup II – Shkup,

GJYKATA THEMELORE SHKUP II – SHKUP

Publikon

SHPLLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM - 1/18

Të njëzetepesë (25) personave për kohë të caktuar për vendet e punës në vijim:

**1. Këshilltar – informaticient – kategoria V1, 3 (tre) realizues;**

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar fakultet nga sfera e informatikës ose fakultet tjetër të sferës përkatëse.

**Përvojë pune:** së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, si dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 të Ligjit për shërbim gjyqësor.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 27.237,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**2. Bashkëpunëtor gjyqësor - kategoria V3,**

6 (gjashtë) realizues;

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar fakultet juridik dhe provim të dhënë të jurisprudencës.

**Përvojë pune:** së paku një vjet përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, si dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 të Ligjit për shërbim gjyqësor.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 24.461,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**3. Bashkëpunëtor i ri gjyqësor - kategoria V4,**

6 (gjashtë) realizues;

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VIII/1 të mbaruar fakultet juridik.

**Përvojë pune:** me ose pa përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, si dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 të Ligjit për shërbim gjyqësor.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 23.098,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**4. Bashkëpunëtor i ri – përkthyes - kategoria V4,**

1 (një) realizues;

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar.

**Përvojë pune:** me ose pa përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, si dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), në pajtim me nenin 11 paragrafi 4 të Ligjit për shërbim gjyqësor.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 23.098,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**5. Referent i ri gjyqësor – realizues në sportel - kategoria G4,**

1 (një) realizues;

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** së paku arsim të lartë ose të mesëm.

**Përvojë pune:** me ose pa përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, si dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit për shërbim gjyqësor.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 15.228,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**6. Referent i ri gjyqësor – procesverbalist - kategoria G4,**

5 (pesë) realizues;

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** së paku arsim të lartë ose të mesëm.

**Përvojë pune:** me ose pa përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, si dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit për shërbim gjyqësor.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 15.228,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**7. Mirëmbajtës të higjienës 2 (dy) realizues;**

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:** arsim të mesëm ose fillor.

**Përvojë pune:** me ose pa përvojë pune

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 12.001,00 denarë.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: e caktuar deri më 31.12.2018.

**8. Vozitës**

1 (një) realizues;

**Kushtet e posaçme**

**Kualifikimet profesionale:**

- së paku arsim të mesëm;

- të posedojë leje të vozitjes të kategorisë "B" më shumë se një vit.


**Përvojë pune:** me ose pa përvojë pune.

Orari ditor i punës është 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte; neto pagesa bazë 14.933,00 denarë.

Kohëzgj







## Bethoveni, pasioni për femrat e panjohura

Ludvig van Beethoven nuk mund të kompozonte pa qenë i frymëzuar. Kur një dashuri ishte e arritshme atëherë muzika nuk kishte ndjesinë e duhur. Kompozitorit i pëlqente vuajtja, ndaj torturohej nga shikimet e vajzave të panjohura. Një ndër këto femra për të cilën Beethoven ka lënë pas dhe letra është ajo që ai e quante "E pavdekshmeja, e dashura ime". Më 6 korrik 1806 ai i shkruante asaj duke e quajtur "Engjëlli im, gjithçka ime, shpirti im!". "Vetëm pak fjalë sot, dhe këto me penën tënde. Nuk do shkruaj deri nesër, pasi do lëviz nga shtëpia me qira. Çfarë humbje kohe. Përse gjithë kjo brengë kur nevoja flet? A mund të rezistoj dashuria jonë përveçse me sakrificë? A mund ta ndryshosh faktin se ti nuk je tërësisht e imja, se unë nuk jam tërësisht yti? O Zot!

Shiko jashtë bukuritë e natyrës dhe qetësoje veten me atë çfarë është. Dashuria kërkon gjithçka dhe kjo është shumë e drejtë. Nëse do ishim tërësisht të bashkuar, ti do ta ndjeje dhimbjen po ashtu si unë. Tani një ndryshim të gjërave të brendshme nga gjërat e jashtme. Me siguri do e shohim njëri-tjetrin. Aq më tepër që unë s'mund të t'i tregoj vëzhgimet që kam bërë gjatë këtyre ditëve të fundit, të cilat kanë prekur jetën time. Nëse zemrat tona do të ishin bashkë, nuk do të kishte ndodhur asgjë nga këto. Zemra ime është e mbushur plot me gjëra që dua të t'i them ty. Ah! Ka momente kur ndjej se fjalët s'janë asgjë. Gëzohu, bëhu e vërteta ime, thesari im, gjithçka ime, ashtu sikurse unë jam i yti. Perënditë duhet të na japin pjesën tjetër, e cila do të jetë më e mira për ne", i shkruante ai asaj. Kjo është vetëm një nga dhjetëra letra nga të cilat nuk mori asnjëherë përgjigje.

# ÇKA I SHKRUANTE FAN NOLI HILTERIT?

Në mes të shqiptarëve të shquar të vitit 1942 që u përpoqën të shpëtojnë nga nazizmi albanologun Norbert Jokli, ishte padyshim edhe Fan Noli. Ishte koha kur nazizmi gjerman i Adolf Hitlerit nuk kursente asnjë hebre

Norbert Jokli ishte albanolog austriak me prejardhje hebreje, një ndër themeluesit e albanologjisë. Ishte profesor në Universitetin e Vjenës. Një personalitet shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Në atë kohë Jokli ishte arrestuar nga forcat e Gestapos dhe ishte vendosur në kampet naziste të përqendrimit. Në atë kohë, Fan Noli vendosi t'i shkruaj Adolf Hitlerit një lutje në emër të të gjithë shqiptarëve për të shpëtuar albanologun hebre, Norbert Jokli.

**Letra: Shqiptarët në vendin e tyre dhe jashtë shtetit janë të shqetësuar për shëndetin e keqësuar të profesorit në pension të Universitetit të Vjenës, dr. Norbert Jokli, autoritetit të gjallë**



**Telegram A. Hitlerit**

Udhëheqësit Adolf Hitler  
1939-1942(?)  
Berlin, Gjermani

Shqiptarët në vendin e tyre dhe jashtë shtetit janë të shqetësuar për shëndetin e keqësuar të profesorit të Universitetit të Vjenës, dr. Norbert Jokli, gjallë më të madh në filologjinë shqiptare dhe shkëlqyer të një vargu të gjatë të studiuesve gjermanë, që kanë bërë një punë të paçmueshme pionieri për historinë, letërsinë dhe folklorin e Shqipërisë. Në emër të gjithë shqiptarëve unë i bëj thirrje shkëlqesisë suaj për ta ndihmuar këtë studiues të madh albanolog në çfarëdo mënyre të përshtatshme në kushtet e tashme të vështira.

Peshkopi Fan S. Noli

më të madh në filologjinë shqiptare dhe pasurit më të shkëlqyer të një vargu të gjatë të studiuesve gjermanë, që kanë bërë një punë të paçmueshme pionieri për historinë, letërsinë dhe folklorin e Shqipërisë. Në emër të gjithë shqiptarëve unë i bëj thirrje shkëlqesisë suaj për ta ndihmuar këtë studiues të madh albanolog në çfarëdo mënyre të përshtatshme në kushtet e tashme të vështira".

Peshkopi Fan S. Noli

Por, kush ishte Norbert Jokli? Norbert Jokli është autor i librave "Studime mbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes" dhe

"Kërkime gjuhësore - kulturore historike nga fusha e shqipes". Jokli krijoi një bibliotekë albanologjike e indogjermanistike me rreth 3000 ekzemplarë libra, prej të cilëve sot kanë shpëtuar më pak se 200 copë. Ndër të tjera ai ruante dorëshkrimin e një Fjalori etimologjik të gjuhës shqipe, i cili ishte vazhdimi ideal i punës së nisur prej G. Meyerit. Norbert Joklit kishte lidhje të ngushta me intelektualë shqiptarë të asaj kohe si Faik Konica, Aleksandër Xhuvani, Ernest Koliqi dhe Gjergj Fishta. Admirues i madh i Fishtës, Konicës, Sqiroit, Naimit dhe traditës bektashjane, njohës i

De Radës dhe i arbëreshëve, simpatizues i Shantojës dhe i Koliqit, Jokli pati një letërkëmbim të dendur me shumë personalitete kulturore dhe politike shqiptare. Në vitin 1937 kishte vizituar një herë të vetme Shqipërinë ku me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, u prit me nderime dhe u nderua me çmimin "Urdhni i Skënderbeut". Megjithë përpjekjet e shumta të autoriteteve shqiptare, Norbert Jokli u arrestua nga Gestapoja në 4 mars 1942 në banesën e tij në Vjenë. Ai ndërroi jetë për shkak të torturave në kampet naziste të vdekjes.

## Mjuzikli për Millosheviqin do të ndajë sërish Ballkanin

Gjatë jetës së tij, Slllobodan Millosheviqi, ndau popujt në Ballkan. E tani, 12 vjet pas vdekjes gjatë gjyqimit të tij për krime lufte, i fuqishmi i dikurshëm i Serbisë pritet të ndajë sërish ata – kësaj here si karakter i një shfaqjeje.

Millosheviqi nisi një valë të nacionalizmit popullist për t'u ngritur në pushtet në Beograd më 1989 teksa komunizmi po binte në mbarë Evropën lindore, e më pas e udhëhoqi Serbinë në një dekadë luftërash në Bosnje, Kroaci dhe Kosovë. I quajtur nga nationalistët serbë si mbrojtës i tyre kundër kroatëve katolikë dhe boshnjakëve e shqiptarëve të Kosovës myslimanë, Millosheviqi u ofendua si diktator brutal nga Perëndimi dhe përfundimisht, pas një fushate bombarduese të NATO-s më 1999, humbi pushtetin dhe përfundoi në gjykim për krime lufte në Hagë.

Një shkriktare me bazë në Beograd, Jelena Bogavac, tani ka shkruar një shfaqje e cila do të luhet nga serbë të Kosovës në



Graçanicë që përpiqet të portretizojë kompleksitetin e plotë të një njeriu që ende fajësohet në Ballkan për vdekjet dhe vuajtjet e dhjetëra mijëra njerëzve.

"Fillimisht kemi dashur të bëjmë një shfaqje për të treguar tregime personale të serbëve të Kosovës në të '90-at, por derisa po i bënim intervistat e kuptuam se gjithçka ishte e ndërlidhur me një emërtues të përbashkët – Millosheviqin", tha për Reuters Bogavac, që e shkroi shfaqjen.

"Në shfaqje po prezantojmë kronologjinë e ngjarjeve që përfundojnë në Hagë", thotë ajo gjatë ushtrimeve për shfaqjen e saj në Beograd. I quajtur "Ngritja – Shou i Slllobodanit", shfaqja është një mjuzikël që përqendrohet më shumë në marrëdhënien e tij personale me bashkëshorten e tij të fuqishme Mirjana, vajzën e tij Marija dhe djalin e tij Marko sesa në politikë, sipas skenarit të përfunduar që e ka parë Reuters. Në një skenë ai ngushëllon të bijën e

tij për shkak të gjendjes së dobët financiare të radio-stacionit të saj, dhe në një tjetër ai i thotë Markos që e mos tejngroh ujin në pishinën familjare. Pjesa e fundit e shfaqjes – gjykimi i tij në Hagë, ku ai vdiq nga një sulm në zemër më 2006 – pritet të përfundojë. Shfaqja nuk pritet të kënaq shqiptarët që përbëjnë shumicën në Kosovë, që shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 2008 në një hap që ende nuk është njohur nga Serbia apo nga 40,000 serbë që ende jetojnë në Kosovë, transmeton koha.net.

Rreth 800,000 shqiptarë u dëbuan dhe rreth 10 mijë të tjerë u vranë nga forcat e Millosheviqit në vitet e '90-ta. "Askush nuk do ta ndryshojë historinë me një shfaqje", thotë Naser Shatroli, regjisor e skenarist. "Nuk ka rëndësi se çfarë thotë shfaqja. Millosheviqi është kriminel, tiran, që shkatëroi rajonin e Ballkanit, jo vetëm shqiptarët, dhe kështu do të mbetet dhe askush nuk do ta ndryshojë këtë".

Nëse në verë lëvizjet ishin më të pakta, tashmë, kur mbeten edhe pak ditë nga mbyllja e merkatos së janarit, shihet një dyndje lojtarësh, që pasi kanë mbyllur pjesën e parë të sezonit në Maqedoni, po firmosin me klubet e Superiores

Shkup, 23 janar - Lojtarët nga Liga e parë e Maqedonisë po "pushtojnë" Kampionatin e Shqipërisë. Prej një viti pjesa dërrmuese e klubeve elitare të futbollit të Shqipërisë kanë hedhur sytë nga tregu maqedonas për t'u forcuar gjatë merkatos. Nëse në verë lëvizjet ishin më të pakta, tashmë, kur mbeten edhe pak ditë nga mbyllja e merkatos së janarit, shihet një dyndje lojtarësh, që pasi kanë mbyllur pjesën e parë të sezonit në Maqedoni, po firmosin me klubet e Superiores. Në një vëzhgim të "Panorama Sport" rezulton se, deri më tani, 19 lojtarë bëjnë pjesë në 10 ekipe të elitës, përfshi këtu edhe Tiranën e Kategorisë së Parë. "Rekordin" e mban Flamurtari me 6 lojtarë, të cilët vetëm një sezon më parë ishin pjesë e klubeve të Ligës së parë si Shkëndija, Renova, Rabotnički, Shkupi dhe Sileksi. Nëse për vlonjatët lidhja mund të bëhet me trajnerin Shpëtim Duro, i cili e njeh mirë kampionatin maqedonas, duke qenë se ka drejtuar Shkëndijen e Tetovës, asgjë nuk mund të quhet e rastësishme për klubet e tjera. Partizani ka të konfirmuar katër lojtarë, Teuta tre, Kamza dy, si dhe Skënderbeu, Vllaznia e Tirana me nga një.

# LOJTARËT NGA MAQEDONIA PO "PUSHTOJNË" SHQIPËRINË



SEZONI 2017-2018	
Lista e futbollistëve që vijjnë nga kampionati maqedonas	
Suad Sahiti	- mesfushor krahu, 22 vjeç (Rabotnički-Skënderbeu)
Goran Siljanovski	- mbrojtësi krahu, 27 vjeç (Rabotnički-Flamurtari)
Artim Pollozhani	- mesfushor, 35 vjeç (Shkëndija-Flamurtari)
Muhamedin Useini	- mesfushor, 29 vjeç (Renova-Flamurtari)
Argjent Gafuri	- mesfushor, 28 vjeç (Renova-Flamurtari)
Fisnik Zuka	- mbrojtës i majtë, 22 vjeç (Shkupi-Flamurtari)
Igor Nedeljković	- mesfushor krahu, 26 vjeç (Sileksi-Flamurtari)
Jasir Asani	- sulmues krahu, 22 vjeç (Vardar-Partizani)
Lukas Kardozo	- sulmues, 23 vjeç (Pelisteri-Partizani)
Emran Ramadani	- sulmues, 25 vjeç (Renova-Partizani)
Besart Abdurrahimi	- sulmues, 27 vjeç (Shkëndija-Partizani)
Demir Imeri	- sulmues, 22 vjeç (Shkëndija-Kamza)
Ilir Avdyli	- portier, 27 vjeç (Shkëndija-Kamza)
Bojan Gjorgjievski	- mbrojtës, 25 vjeç (Pobeda-Teuta)
Burhan Mustafov	- mesfushor, 23 vjeç (Pobeda-Teuta)
Amir Bilali	- mbrojtës, 23 vjeç (Rabotnički-Teuta)
Sedat Berisha	- mbrojtës, 28 vjeç (Shkupi-Vllaznia)
Aleksandar Ristevski	- mbrojtës, 25 vjeç (Pobeda-Tirana)

Me merkaton që është në kulmin e saj, nuk është çudi që, numri i lojtarëve që vijjnë nga klubet maqedonase, të rritet. Në këtë vëzhgim të gazetës nuk janë futur

edhe dy lojtarë, të cilët kanë të kaluar me klubet e vendeve fqinje, por në fakt gjatë sezoneve të fundit kanë qenë pjesë e kampionateve të tjera. Bëhet fjalë për mbrojtë-

sin Egzon Belica (ish-lojtar i Shkëndijës) dhe sulmuesin Muarem Muarem (ish-lojtar i Rabotniçkit), që kanë firmosur për Partizanin dhe Flamurtarin. Ndërkohë, janë dy motivet kryesore pse klubet shqiptare po fokusohen gjithnjë e më tepër nga lojtarët e kampionatit fqinj. Së pari, pas vendimit të FSHF-së në prag të fillimit të sezonit 2017-2018, lojtarët me pasaportë maqedonase nuk do të cilësohen më të huaj. Së dyti, në shumicën e klubeve maqedonase, mund të gjejsh elementë cilësorë, të cilët nuk kanë një kosto të lartë financiare. Gazeta mëson se, përveç dy klubeve me buxhete që i kalojnë dy milionë eurot në sezon si Vardar i Shkupit dhe Shkëndija e Tetovës, në skuadrat e tjera të Maqedonisë ka probleme të mëdha financiare dhe natyrisht paga të ulëta. Mesatarja e rrogave mujore



• Fisnik Zuka (Flamurtari)



• Argjent Gafuri (Flamurtari)



• Sedat Berisha (Vllaznia)

në këto ekipe nuk shkon më shumë se 2 mijë euro. Kësisoj, në një treg ku diferencën në pagesa e bën gjithnjë Vardari dhe Shkëndija, klubet shqiptare kanë mundësinë të "peshkojnë" lojtarë që mund të shpërthejnë në Superiore në skuadra si Rabotnički, Renova, Shkupi, Pobeda, Pelisteri, Sileksi etj. Nga ekipet e Superiores vetëm Laçi, Kukësi, Luftëtari dhe Lushnja nuk ka preferuar të marrin lojtarë nga tregu fqinj, por megjithatë duhet pritur mbyllja e merkatos.

## Bari mposhti konkurrencën e Empolit për Memushajn



Zbulohen detaje të reja rreth transferimit të Ledian Memushajt te Bari në Serinë B. Sipas Gazzetta Dello Sport, futbollisti ka pranuar ofertën ekonomike të skuadrës puljeze dhe tashmë pret vetëm "ok" përfundimtar të Beneventos. Në fakt, sikurse thekson kjo e përditshme, për futbollistin e Kombëtares Shqiptare kishte ardhur një ofertë edhe nga Empoli, por ajo e Barit ishte me kushte më të mira, ndaj Memushaj ka preferuar të

jetë nën urdhrat e trajnerit Fabio Grosso. Në prononcimin e fundit pas ndeshjes së humbur 3-0 në transfertë me Bolonjën, vetë Memushaj u tregua i sinqertë, duke deklaruar se pavarësisht dëshirës për të qëndruar, nuk mund të betohej për vijimin e karrierës te skuadra nga Kampania. Zyrtarizimi i marrëveshjes, nga e cila Benevento do të përfitojë 500 mijë euro, pritet të ndodhë para fundjavës.

## Belica firmos me Partizanin për një vit e gjysmë

Shkup, 23 janar - Mbrojtësi strugan Egzon Belica, edhe zyrtarisht ka firmosur kontratën me drejtuesit e klubit dhe më pas është prezantuar si lojtar i Partizanit. Klubi nga Tirana ka konfirmuar këtë përmes një deklarate për shtyp. "Partizani njofton arritjen e marrëveshjes me Egzon Belicën. Mbrojtësi 27-vjeçar, i cili ishte pjesë e skuadrës përgjatë fazës përgatitore në Antalia, ka nënshkruar me 15 herë kampionët e vendit një kontratë për 1 vit e gjysmë. Pas firmës së hedhur në kontratë, Belica ka kryer edhe prezantimin në ambientet e klubit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Partizanit. Ndërkohë, Partizani ka hyrë në ciklin përgatitor të ndeshjes së javës së 17-të të Superiores, ndaj Flamurtarit, të cilën do ta luajë në Vlorë, të premtën. Trajne-



ri Sulejman Starova po përvijon tashmë formacionin e mundshëm, me të cilin do të startojë në këtë transfertë, pas largimeve të janarit. Krahas kësaj, "Bobi" ka pasur nën vëzhgim edhe dy-tre lojtarë, të cilët kanë zhvilluar përgatitoren

dimërore në Antalia me "demat". Cekim, gjatë karrierës së tij Belica ka qenë pjesë e të rinjve të Karaormanit, Besës nga Kavaja, Vllaznimit, Rabotniçkit, Ohrit, Konkordias, Shkëndijës dhe së fundmi Inter Turku.



SIPAS PRESIDENTIT TË FEDERATËS SË FUTBOLLIT TË EGJIPTIT,  
HANY ABO RIDA

# REALI DO TË BËJË SUPEROFERTË PËR SALAH KËTË VERË



“Ekziston një mundësi e vërtetë, që ai mund të luajë për Real Madridin sezonin e ardhshëm. Klubi spanjoll do të bëjë një ofertë të madhe. Salah tani po kërkon të përmirësojë lojën e tij. Natyrisht, nëse një egjiptian luan për një klub të tillë popullor në botë, si Real Madridi, do të jetë diçka e madhe për futbollin egjiptian”, – thotë Abo Rida

Mohamed Salah është një nga lojtarët me më shumë projeksion i skenës botërore dhe në kohët e fundit po flitet se për të ka një interes të madh nga ana e Real Madridit. Presidenti Florentino Perez duket i vendosur për ta marrë sulmuesin egjiptian. I fundit, që e ka konfirmuar këtë interesim, ka qenë presidenti i Federatës së Futbollit të Egjiptit, Hany Abo Rida. Ai supozon se “klubi madrilen do të paraqesë një ofertë të madhe për lojtarin”, duke miratuar atë që tha Hektor Kuper në dhjetor. “Ekziston një mundësi e vërtetë, që ai mund të luajë për Real Madridin sezonin e ardhshëm. Klubi spanjoll do të bëjë një ofertë të madhe. Salah tani po kërkon të përmirësojë lojën e tij. Natyrisht, nëse një egjiptian luan për një klub të tillë popullor në botë, si Real

Madridi, do të jetë diçka e madhe për futbollin egjiptian”, – pranoi ai. Hany Abo Rida supozon se Florentino Perez do ta paraqesë ofertën e duhur për Liverpoolin në pak muaj, për ta marrë golashënuesin. Arsyja kryesore është rifreskimi i sulmit të bardhë, si një masë kundër rënies sportive që po kalon Benzema dhe Cristiano Ronaldo. Numrat e Salah këtë sezon janë të jashtëzakonshëm: ai ka shënuar 18 gola në 23 ndeshje të luajtura në Premier Ligë, 24 gola në total, në të gjitha garat. Në moshën 25-vjeçare, ai është në një nga lojtarët kyç për Jurgen Klopp.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1, pika 1, paragrafi 4, dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune- tekst i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë” nr. 167/2015) dhe neni 80, 82 paragrafi 1, 3 dhe 4 nga Ligji për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 4/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/15, 98/15, 145/15, 30/2016 dhe 127/16 ), dhe në bazë të miratimit nga ana e Ministrisë për Arsime dhe Shkencë nr. 12-14980/3 nga 15.01.2018, SHFKM “Ordan Mihajloski-Ocka”-Prilep më datë 24.01.2018 shpall:

#### SHPALLJE PUBLIKE

për përbushjen e vendeve të punës bazuar në financimin e vjetër zëvendësim të U. D Drejtor, për një kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018 por jo më vonë prej 31.08.2018 dhe atë:

1. Mësues për Solfezh dhe teoria e muzikës me kohë të plotë të punës /20 orë mësimore në javë/ dhe paga neto prej 23.027.00 den.

Orari i punës i mësuesve është 5 ditë pune në javë (prej të hënës deri të premten) me ndërrime, ndërrimi i parë fillon në ora 07:30 ndërsa ndërrimi i dytë në 13:30. Orari i punës bëhet në përputhje me orarin e orëve të nxënësve për vitin shkollor 2017/18.

Punëtorët kanë të drejtë për pushim ditor, mujor dhe vjetor sipas ligjit për marrëdhënie pune. Kandidatët për vendin e punës me numër rendor 1 deri 5, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj të plotësojnë dhe kushtet e parapara në nenin 78 dhe 80 prej Ligjit për arsim të ulët (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 4/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/15, 98/15, 145/15, 30/2016 dhe 127/16), dhe rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në shkollë.

Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkurs duhet ti dorëzojnë:

- Aplikim në konkurs publik;
- Diplomë/Vërtetim/ për arsim të përfunduar (kopje e notuarizuar);
- Certifikata e Shtetësisë;
- Biografi e shkurtë-CV;

Konkursi zgjatet 5/pesë/ ditë nga dita e publikimit në gazetë ditore, dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara jo në kohë nuk do të merren parasysh. Punëtori pranohet për kohë të caktuar të punës deri në ndërprerjen e funksionit të U.D Drejtor, Drejtor por jo më vonë se deri më 31.08.2018 për vitin shkollor 2017/2018. Përzgjedhja do të bëhet brenda 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë duke përfshirë ditën e mbylljes së konkursit. Dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet në origjinal ose të notuarizuar deri tek shkolla “Ordan Mihajloski-Ocka”-Prilep, rr. Orce Tuteski, nr. 19 Prilep tel. 048/415-715 personi për kontakt Bllagoja Kareski. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara jo në kohë nuk do të merren parasysh.

Data 24.01.2018  
U. D Drejtor  
Rolina T. Dimeska

#### URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093



Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor  
dhe Planifikimit Hapësinor



Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë  
SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit për përdorim industrial, teknologjik dhe komercial, në lokacionin PK 4572, KK Resnjë, Komuna e Resnjës.

Në pajtim me nenin 30 paragrafin 1 të Ligjit të Ujërave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit për ujti në lokacionin PK 4572, KK Resnjë, Komuna e Resnjës me numër të arkivit nr. UPI-11-5/1433/2017 prej 17.10.2017

Parashtruesi i kërkesës:  
“Vita Res” SHPK Resnjë  
Rruga 29 Nëntori nr. 1/26  
7310 Resnjë

Koordinatat e puseve eksploative B-1 PK 4572, KK Resnjë, Komuna e Resnjës,  
sipas sistemit shtetëror koordinativ:

Pusi X-502 567.27

Y-549 132.24

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail [H.Rexhepi@moep.gov.mk](mailto:H.Rexhepi@moep.gov.mk)

Publiku i tanguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë që të dorëzojë mendime dhe komente në formë të shkruar në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bul. “Goce Dellçev” nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

#### SHPALLJE

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit për kultivimin e peshqve në akumulacionin “Liqeni i Tikfeshit” në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 i Ligjit për ujërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 136/13, 180/14, 146/15 dhe 15/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë, është dorëzuar kërkesë për dhënie e Lejes për përdorimin e ujit për rritjen e peshqve në akumulacionin “Liqeni i Tikfeshit” me PA1 nr.11/5-1736 prej 22.12.2017v.

Parashtruesi i kërkesës

TI KRAP Kavadar

rr. “Ilindenska” nr.115-1/9, Kavadar

Objektet, kafazet janë të definuara sipas sistemit nacional të koordinatave:

- |                  |              |
|------------------|--------------|
| 1. Y=7579753.72; | X=4582684.35 |
| 2. Y=7579792.70; | X=4582694.97 |
| 3. Y=7579797.27; | X=4582678.18 |
| 4. Y=7579785.88; | X=4582675.08 |
| 5. Y=7579796.92; | X=4582634.55 |
| 6. Y=7579780.13; | X=4582629.98 |
| 7. Y=7579777.03; | X=4582641.37 |
| 8. Y=7579766.23; | X=4582638.42 |

SANÇEZ MERR "7" E RONALDOS, KANTONAS DHE BEKAM

# ERDHA PËR SHKAK TË MANÇESTERIT DHE MURINJOS



Trajneri Murinjo dhe Mançester Junajtedi, që e kërkuan me ngulm, ishin një faktor i rëndësishëm në vendimin e tij për t'u bashkuar me klubin nga "Old Trafford". "Hoze tregoi se është e rëndësishme për klubin që unë të jem këtu", – tha Sançez për "MUTV"

Marrëveshja me kohë të parashikuar për shkëmbim, që pa drejtimin e Henrikh Mikhitaryan në drejtimin e kundërt të sulmuesit kilen, përfundoi të hënën, duke sjellë në finish një nga transferimet më të mëdha të janarit. Alexis Sançez thotë se trajneri Hoze Murinjo dhe Mançester Junajtedi, që e kërkuan me ngulm, ishin një faktor i rëndësishëm në vendimin e tij për t'u bashkuar me klubin nga "Old Trafford". "Hose tregoi se është e rëndësishme për klubin që unë të jem këtu", – tha Sançez për

"MUTV". "Gjithashtu, besoj se vetë klubi është kujdesur për mua, që të bashkohem. Kam përshtypjen se të gjithë ishin të etur për mua, që të vija këtu dhe të vishja fanellën me numrin shtatë. I takon lojtarit të kuptojë nëse ndihet i rëndësishëm dhe i dashur nga klubi që e kërkon. Kjo ishte një nga gjërat që më tërhoqi të vij këtu, së bashku me trajnerin, i cili është një person që ka fituar gjithçka në Itali, njësoj si në Spanjë. Hoze Murinjo është një trajner që i pëlqen të fitojë", u shpreh Sançez. Ish-sulmuesit të

Barcelonës i është dhënë fanella me numrin "7" dhe Sançez është i gëzuar nga vizionet e së kaluarës së Mançester Junajtedit, të krijuar nga fanella e tij e re. "Kur më thanë se Cristiano Ronaldo, Erik Kantona dhe Dejvid Bekam e kishin veshur këtë fanellë, vetëm duke menduar për atë numër shtatë, ju ëndëroni rreth fitimit të trofeut të Ligës së Kampionëve dhe Premier Ligës", – vazhdoi ai. "Po, po, unë jam duke përmbushur një ëndërr dhe shpresoj të jap më të mirën time, të fitoj shumë trofe në këtë klub".



## Kam tentuar disa herë të vras veten

Ish-notari amerikan Majkell Felps, sportisti me më shumë medalje olimpike (28), nga të cilat 23 të arta, ka deklaruar gjatë një takimi të zhvilluar në Çikago se disa vite më parë, kur ka qenë në depresion, ka tentuar disa herë të vrasë veten. Kjo ngjarje ka ndodhur pas Olimpiadës së vitit 2012, të zhvilluar në Londër. Duke folur në një konferencë të shëndetit mendor të organizuar në Çikago, Felps ka folur për betejën e gjatë që ka bërë me depresionin, duke inkurajuar të rinjtë që të bëjnë si ai dhe të luftojnë për të dalë nga kriza. 32-vjeçari, tha: "Pas çdo Olimpiade kam rënë në një depresion të madh. Nuk kam dashur që të garoja më, të rikthehesha në pishinë dhe kam tentuar të vetëvritem. Të gjithë mendojnë se fama mund të sigurojë një të ardhme të sigurt, duke qenë njerëz të fortë fizikisht dhe psikologjikisht, por jemi edhe ne njerëz me ndjenja. Por kam arritur të dal nga kriza dhe të rikthehem në pishinë fitues dhe më pas ia dola të mposhtja gjithçka, si domos kur krijova familje dhe e pata më të lehtë shkëputjen nga sporti", deklaroi Felps.



## Rusi 2018-të hyn në histori pa filluar

FIFA ka vendosur të përdorë sistemin "VAR" në Kupën e Botës që do të luhet verën e ardhshme në Rusi. Lajmi është bërë i ditur nga drejtuesi i organizatës që drejton futbollin botëror, Filipp Le Floh. "Është e sigurt që do të përdoret VAR", – ka thënë Le Floh. –

Mendoj se është fantastik përdorimi i teknologjisë në futboll sepse garanton drejtësi". Sistemi në fjalë ka marrë vlerësime dhe kritika nga lojtarët dhe trajnerët e futbollit. Veçanërisht në Itali, ku është përdorur që në fillimin e sezonit aktual.

Riders	Salary	Team
Marc Marquez	\$11.5 Million	Repsol Honda Team
Valentino Rossi	\$10 Million	Movistar Yamaha
Jorge Lorenzo	\$8 Million	Ducati Team
Andrea Dovizioso	\$7 Million	Ducati Team
Maverick Vinales	\$5 Million	Movistar Yamaha
Dani Pedrosa	\$3.3 Million	Ducati Team
Johann Zarco	\$3 Million	Monster Yamaha Tech 3
Daniilo Petrucci	\$2.8 Million	Octo Pramac Racing
Cal Crutchlow	\$2.5 Million	LCR Honda Castrol
Andrea Iannone	\$2 Million	Team Suzuki Ecstar
Scott Redding	\$1.8 Million	Aprilia Racing Team Gresini
Jonas Folger	\$1.5 Million	Monster Yamaha Tech 3
Álex Rins	\$1.25 Million	Team Suzuki Ecstar

## Zbulohen rrogat e pilotëve të Moto GP

Botërori 2018 i Moto GP është në prag, me testet e para dimërore që nisin në fund të këtij muaji. Revista financiare "Forbes" ka zbuluar pagat e pilotëve të këtij kampionati, ku në krye të renditjes është kampioni i botës në fuqi, spanjulli i Honda, Mark Markuez. Ai fiton 11.5 milionë dollarë, ndjekur nga Valentino Rossi me Jamaha, me 10 milionë.

Ata janë dy pilotët e vetëm që kanë rroga "dy shifrore", ndërsa i treti është piloti i Dukati, Jorge Lorenzo, që paguhet 8 milionë dollarë, një më shumë se shoku i skuadrës Andrea Dovizioso edhe pse ky i fundit u rendit më mirë se spanjulli sezonin e kaluar.







## SHARON STONE, puthje e përçafime me një djalosh misterioz

Sharon Stone vazhdon të tërheqë vëmendjen e publikut. Do të mbushë 60 vjeçe këtë mars, por sërish shpërfaq sensualitet rreth vetes. Edhe pse kohët e fundit kishte deklaruar se nuk ishte në kërkim të një dashurie, është fotografuar me një mashkull në Nju Jork. Në premierën e serisë HBO "Mosaic", është paraqitur dorë për dorë me një djalë më të ri në moshë. Por jo vetëm: të dy janë fotografuar gjatë një puthjeje pasionante. Mbetet për t'u kuptuar tani se cili është shoqëruesi misterioz i yllit të "Basic Instinct"?



## Arrestohet piloti që donte të drejtonte i dehur aeroplanin

Fluturimi i British Airways në linjën Londër-Mauricius, u vonua për dy orë për shkak të pilotit, i cili në gjendje të dehur donte të drejtonte aeroplanin. Sipas BBC, ai u nxor nga avioni nga policia dhe u dërgua në ndërtesën e aeroportit me pranga.



## Ku kanë përfunduar flokët Princi William?

Koha kalon dhe flokët në vend që të thinjen... bien. Dhe kështu Princi William i është dorëzuar faktit dhe i ka dhënë një prerje të plotë flokëve duke u qethur praktikisht zero. Një "look" i ri, me të cilin prezantohet për herë të parë me rastin e një vizite në një qendër veteraneshe. Një fakt i tillë nuk u ka shpëtuar tabloidëve britanikë, të cilët e kanë cilësuar rastin me tituj të tipit "God shave the king".



## U vra për një autogol, pas 24 vitesh arrestohet porositësi i atentatit të mbrojtësit kolumbian



24 vite më parë, mbrojtësi dhe njëherazi kapiteni i kombëtares kolumbiane të futbollit të asaj kohe, Andres Escobar u ekzekutua vetëm 5 ditë pas kthimit në vendlindjen e tij. E gjitha kjo ndodhi për shkak të një autogoli, që Escobar shënoi në sfidën SHBA-Kolumbi dhe që i kushtoi eliminimin kolumbianëve. Ngjarja ndodhi në 2 Korrik 1994, në një bar në Medellin dhe mbrojtësi atëherë 27-vjeçar, u qëllua me 3 plumba, që i morën jetën. Sot, 24 vite pas atentatit, u arrestua Santiago Gallon Henao, një tregtar droge, që është provuar se ka urdhëruar ekzekutimin e kapitenit të Kolumbisë. Ky ishte një lajm mjaft i mirë për familjen e Escobar, që pas 24 vitesh mund të ngushëllohet me vendosjen e drejtësisë. Autogoli i shënuar në Botëror, ishte i pari për Escobarin, por i kushtoi jetën atij, pasi tregtari i drogës kishte humbur një sasi të madhe parash në baste, për atë sfidë dhe vendosi të hakmerrej duke urdhëruar vrasjen.



KALENDARI HISTORIK 24 JANAR

- 41 - Vritet Gaj Cezari (Kaligula), i njohur për nga despotizmi i tij i vrazhdë.
- 1458 - Matias I Korvini zgjidhet Mbret i Hungarisë.
- 1679 - Mbreti Çarls II shpërndan Parlamentin anglez.
- 1722 - Cari Pjetri i Madh fillon sistemin civil.
- 1857 - Themelohet Universiteti i Kalkutës, si universiteti i parë i kompletuar në Azinë jugore.
- 1859 - Bashkimi politik mes Moldavisë dhe Vllahisë.
- 1862 - Bukureshti shpallet kryeqyteti i Rumanisë.
- 1924 - Qyteti rus Shën Petersburgu emërohet Leningrad.
- 1941 - Trupat britanike marshojnë në Abisini.
- 1943 - Hitleri urdhëron trupat e tij në Stalingrad të luftojnë deri në vdekje.
- 1960 - Algjeri rebelohet kundër Kryetarit francez De Goll.
- 1993 - Gazetari dhe shkrimtari turk Uğur Mumcu vritet në automobil bombë në Ankara.



Personi mesatar konsumon rreth 35 ton ushqim gjatë jetës së tij/saj.



Zemra rreh 35 milionë herë në vit. Po, 35 milionë. Një vit!



Secili njeri e shtypë gjuhën në mënyrë unike, tregojuni miqve për këtë.



BARSOLETA

Pse biondet i fusin paratë nën sqetull? Për të thënë që i kanë fituar me djersë!

\*\*\*

Si porosit biondina një kafe të mesme? I porosit tre kafe dhe e pi atë të mesit.



THËNIA E DITËS



Vetëm njerëzit e vegjël përpiqen të poshtërojnë dhe të ulin të tjerët. Kush nënvlerëson është vlerëpak. (Khalil Gibran)